

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7770 E hënë 21 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

**P**ohimi dy ditë më parë për kandidim për së dyti në zgjedhjet vendore të qershorit 2019 të Kryetarit të sotëm të bashkisë së kryeqytetit, erdhi në mes të një vorbulle idesh...

Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI

**Të largoj pulën e florinjët?!**



Opinion i Ditës

**T**ë shohësh qartë e vepros drejtë kur askush nuk kupton më asgjë, kërkon mençuri të pamatë por edhe kurajo pakufij. Aktet e liderëve që bëjnë histori...

Vijon në faqen 20

Nga ARIAN GALDINI

**Ramushi, taksa dhe të tjerët!**



“Kemi shpresë të SPAK dhe BKH”  
**21 janari, familjarët e Ziver Veizajt: Statusi i dëshmorit nuk është drejtësi**

Motra dhe vëllai i protestuesit të vrarë më 21 janar: Çdo vit, presim të dënohet dikush

Në 8 vjetorin e ngjarjes së 21 janarit, familjarët e 4 të viktimave që mbetën të vrarë gjatë protestës së opozitës së atëhershme kërkojnë sërish drejtësi. Të zhgënjyer nga shteti dhe në mënyrë të veçantë nga institucionet e drejtësisë, familjarët e Ziver Veizit, një prej të vrarëve në 21 janar të 2011, thonë se edhe sot, 8 vite më pas...

Në faqen 7

**INSTITUTI I SIGURIMEVE: DOKUMENTACIONI, E MARRIN JETIMET DERI NE 18 VJEÇ**

## PENSIONI FAMILJAR, JA KUSH E PERFITON

Prindërit e paaftë për punë, burri i ve me femijë deri në 8 vjeç, të gjitha kategoritë që marrin kompensimin financiar. ISSH: Ja rastet kur mund ta humbni të drejtën



(Në foto) Foto ilustruese

Në faqen 8-9

KRYEMADHI

**“Në qershor edhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare”**

Në faqen 4

OPOZITA

**Dita e 77 e protestës, Balliu: Rrëzimi i Ramës është domosdoshmëri**

Në faqen 4

SI TË TRAJTONI ULÇERËN

**Hemorragjitë në traktin e sipërm, si duhen mjekuar**

Suplement

PROTESTA

**‘Rrethohet’ parlamenti grek, Marrëveshja e Prespës, Athina ‘zien në flakë’**

Në faqen 12

HETIMET



**Zija Çela: Kurora ime e artë mbi varrin e Shuteriqit, është mirënjohja**

Në faqen 10-11

Gati fushata/ Veliqaj në Tiranë, Çela në Durrës, Llatja në Elbasan, Ndreu në Lezhë

## Zgjedhjet, kandidatët e PS në bashkitë kryesore

Më 30 mars mbledhet Kongresi, kush janë kryebashkiakët që nuk rikandidojnë

Gati 5 muaj nga zgjedhjet për pushtetin vendor, partitë kryesore politike, ndonëse kanë nisur organizimet e strukturave, nuk kanë bërë ende përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve për kryetar bashkie. Ndërsa në kampin opozitar çështja mbetet tek arritja e një mar-



rëveshje me dy forcave kryesore të këtij blloku, PD-LSI, socialistët nga ana tjetër, për shkak edhe të një taktike elektorale, kanë hezituar deri më tani që të bëjnë publik emrat me të cilët do përfaqësohen në zgjedhjet e ardhshme lokale. Zyrtarisht deri më...

Në faqen 3

# VENDORET 2019

## FUSHATA

Socialistët kanë miratuar një kalendar të detajuar për organizimin elektoral

# PS masterplan organizativ për zgjedhjet dhe census për votën

Në mes të marsit do hapen zyrat elektorale në çdo bashki

Krahas administrimit të pushtetit dhe përballja me protestat shumta, socialistët i pret edhe një fushatë elektorale e vështirë për të siguruar një fitore tjetër në zgjedhjet vendore. Kjo pasi ata duhet t'i bëjnë llogaritë jo vetëm në kushtet e një konsumimi politikë që sjellë qëndrimi për një kohë të gjatë në pushtet, por edhe në kushtet kur nuk kanë me vete asnjë nga partitë e dorës së dytë për të mundësuar ndonjë koalicion parazgjedhor. Në këto kushte Partia Socialiste suksesin në zgjedhjet vendore të 30 qershorit ia ka besuar plotësisht organizimi strukturor dhe elektoral të partisë. Për këtë qëllim, selia rozë ka hartuar një masterplan të detajuar të aktiviteteve operacionale dhe organizative të fushatës elektorale. Masterplani përfshin planifikimin organizativ elektoral dhe shtrirjen kohore brenda së cilës duhet të çdo veprim nga ana e strukturave të PS-së, nga qendra deri në bazë. Më konkretisht përveç përgatitjeve fillestare që kanë të bëjnë me planin e përgjithshëm të organizimit të fushatës, ky dokument e ndan punën kryesisht në e etapë: aktivitetet përpara fillimit të fushatës, aktivitetet gjatë fushatës, dhe dita e votimit.

### PARA FUSHATËS

Kjo fazë parashikohet të shtrihet në muajt shkurt, mars dhe prill dhe puna për këtë do konstatohet rishikimin dhe përditësimin periodik të planit të përgjithshëm të fushatës, si dhe në përcaktimin e mesazhit të fushatës. Pjesë e kësaj faze është puna për identifikimin e çështjeve me interes për komunitetin si premtime për të ardhmen, identifikimi i çështjeve që mund të përdoren kundër kandidatit kundërshtar dhe përditësimi strukturave me mesazhin politikë që duhet të shpërndahet prej tyre të zgjedhësit. Gjithashtu gjatë kësaj faze parashikohet të ndodh edhe riformatimi i organizatave socialiste, ngritja e strukturës së koordinimit elektoral, si dhe fushata e pranimeve të reja në PS. Po ashtu një moment i rëndësishëm gjatë kësaj faze është edhe ngritja e grupeve të censusit të votës. Kështu Partia Socialiste ka parashikuar që në javën e fundit të shkurtit të nisë punën për censusin e votës, çka do të thotë që organizatat socialiste do të bëjnë identifikimin e votuesve që do votojnë PS, individët apo grupet shoqërore që mund të mbështesin kandidatët socialistë në zgjedhje, si identifikimi i vullnetarëve që mund të bëhen pjesë e fushatës zgjedhore. Një tjetër proces shumë i rëndësishëm që parashikohet të ndodhë në



**CENSUSI**  
Partia Socialiste ka parashikuar që në javën e fundit të shkurtit të nisë punën për censusin e votës, çka do të thotë që organizatat socialiste do të bëjnë identifikimin e votuesve që do votojnë PS, individët apo grupet shoqërore që mund të mbështesin kandidatët socialistë në zgjedhje, si identifikimi i vullnetarëve që mund të bëhen pjesë e fushatës zgjedhore

**KOALICIONI**  
Ndonëse shumica e partive të dorës së dytë janë grupuar në koalicionin opozitar, PS synon që edhe në këto zgjedhje të ketë një koalicion të vetin. Për këtë janë parashikuar që gjatë muajve janar, shkurt dhe mars të mbahen disa takime me kryetarët e partive të vogla.



Kryeministri Edi Rama gjatë një takimi elektoral

## Socialistët grup pune për ndryshimet në statutin e partisë

Më 30 mars socialistët do të mbledhin Kongresin Zgjedhor të Partisë Socialiste, ku veç shpalljes së platformës për fitimin e zgjedhjeve të ardhshme vendore, miratimit të kandidatëve, do bëhet edhe miratimi i ndryshimeve në statut. Për këtë qëllim Asambleja Kombëtare e Partisë Socialiste miratoi në fund të dhjetorit edhe grupin e punës që do merret me hartimin e draft-statutit të ri të Partisë Socialiste. Siç bëhet e ditur në vendimin e asamblesë, grupi i punës do të drejtohet nga kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla dhe në përbërje të tij do të jenë disa figura të njohura të kësaj force. Kështu, pjesë e tij do jetë i gjithë sekretariatit organizativ i Partisë Socialiste, më konkretisht

- GRUPI I PUNËS**
- Taulant Balla
  - Arben Pëllumbi
  - Alfred Peza
  - Bledar Çuçi
  - Blerina Gjylameti
  - Elisa Spiropali
  - Ilir Beqaj
  - Laert Duraj
  - Senida Mesi
  - Teuta Vodo

pjesë e grupit është Sekretari Organizativ i PS-së, Arben Pëllumbi, Sekretari për Marrëdhëniet me Median dhe Shoqërinë Civile, Alfred Peza, Sekretari për Çështjet Zgjedhore, Bledi Çuçi, Sekretarja për Koordinimin Elektoral, Blerina Gjylameti, Sekretarja për Bashkëqeverisjen dhe Aleanca, Elisa Spiropali, Sekretari Digital,

Ilir Beqaj, Sekretari për Emigracion Laert Duraj, Sekretarja për Burimet Njerëzore, Senida Mesi dhe Sekretarja për Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Teuta Vodo. Në vendimin e asamblesë cilësohet, gjithashtu, se ky grup pune nuk do punojë për amendime të statutit aktual, por për miratimin e një statuti të ri. Hartimi i një statuti të ri sipas këtij vendimi është bërë i nevojshëm për t'i dhënë PS-së një skemë organizimi moderne dhe për ta përshtatur me zhvillimet e kohës. Në funksion të këtij procesi grupi i punës do zhvillojë konsultim të gjerë me strukturat dhe forumet qendrore dhe vendore të partisë, si dhe do të konsultojë përvojën e partive simotra evropiane dhe të internacionales socialiste.



## PS organizim digjital për zgjedhje, strukturë komunikimi në whatsapp

Në kuadër të masave organizative për zgjedhjet e ardhshme vendore, Partia Socialiste ka vendosur që të kalojë nga regjistri në letër i anëtarësisë në regjistrin digjital. Për këtë qëllim brenda këtij muaji mësohet se PS do të ndërtojë një platformë elektronike për regjistrimin e administrimin e informacionit të strukturës organizative të anëtarësisë dhe burimeve njerëzore të partisë. Ndërkohë që burime nga PS kanë bërë me dije se është përpiluar skema e organizimit digjital të PS dhe është ngritur një strukturë e posaçme komunikimi nëpërmjet rrjetit whatsapp që do të funksionojë deri në nivelin e kryesive socialiste të njësive administrative. Gjithashtu një skemë e tillë organizimi digjital, por kësaj here jo vetëm nëpërmjet whatsapp-it por edhe nëpërmjet mesazheve të shkruara do të ngrihet në nivel organizate socialiste.

edhe identifikimi dhe trajnimi i komisionerëve të komisioneve zgjedhore dhe grupeve të numërimit. Ndërkohë që faza e tretë që ka të bëjë me fazën e votimit është me shumë një punë me menaxhimin e procesit zgjedhor, duke përfshirë mbështetjen e komisionerëve, raportimin e problematikave, identifikimin e votuesve dhe lajmërimin e zgjedhësve socialistë që nuk kanë votuar ende për të marrë pjesë në procesin e votimit.



Veliaj, Çela, Mesi, Llatja, Ndreu, Subashi, disa nga emrat që do përfaqësojnë PS-në

# Zgjedhjet vendore, kandidatët potencialë të PS për bashkitë kryesore

Qazim Sejдини dhe Vangjush Dako pritet të mos kandidojnë

Gati 5 muaj nga zgjedhjet për pushtetin vendor, partitë kryesore politike, ndonëse kanë nisur organizimet e strukturave, nuk kanë bërë ende përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve për kryetar bashkie. Ndërsa në kampin opozitar çështja mbetet tek arrija e një marrëveshje mes dy forcave kryesore të këtij blloku, PD-LSI, socialistët nga ana tjetër, për shkak edhe të një taktike elektorale, kanë hezituar deri më tani që të bëjnë publik emrat me të cilët do përfaqësohen në zgjedhjet e ardhshme lokale. Zyrtarisht deri më tani është deklaruar se kjo do të vendoset nga strukturat partiake, pas një analize që do të bëhet punës së kryebashkiakëve aktual, por edhe testimi të mbështetjes së kandidatëve potencial në sondazhet e brendshme. Gjithsesi për një pjesë të mirë të bashkive kryesore në vend situata duket më e qartë dhe në korridorët e PS kanë nisur të qarkullojnë emrat potencial me të cilët socialistët do të konkurrojnë për të fituar zgjedhjet e ardhshme vendore.

kampin e djathtë deri më tani flitet për dy kandidatë të mundshëm, deputeti Oerd Bylykbashi dhe ish-kryetari i FRD-së, Gazmend Oketa, i rikthyer së fundmi në PD. Ndërkohë që në kampin e majtë duke thuar se i sigurt kandidimi i kryetarit aktual, Vangjush Dako, kjo jo vetëm për shkak të numrit të madh të mandateve që ai e drejton këtë bashki, por më së shumti edhe për përfshirjen në përgjimet që e lidhin me disa element kriminal nga Shijaku. Vetë Dako disa muaj më parë do të deklaronte se e shihte veten jashtë

garës. "Nuk ndjehem i lodhur, por e shoh veten në një pozicion tjetër. Por një gjë është e sigurt, që unë do të drejtoj fushatën për të gjithë qarkun", - deklaroi atëherë Dako. Për zëvendësimin e tij, burime nga PS bëjnë të sigurt kandidimin e kreut të OSHEE-së, Adrian Çela. Çela konsiderohet nga socialistët si një nga drejtorët më të suksesshëm të qeverisjes së tyre, ndërkohë që ka një favor të madh në këtë kandidim sepse e njëjtin mirë pushtetin vendor dhe Bashkinë e Durrësit, pasi më parë ka qenë nënkryetar i saj.

**KANDIDATËT E T.JERË**  
Burime nga Partia Socialiste e quajnë të larguar Qazim Sejđin, i cili ka tashmë disa mandate në krye të Bashkisë së Elbasanit dhe konsiderohet si një emër i konsumuar tashmë. Në vend të tij burime pranë PS-së kanë bërë të sigurt kandidimin e Gledian Llatjas. Llatja ka qenë shefi i kabinetit të Damian Gjinkuri, ndërsa prej një jave ai është emëruar si Prefekt i Elbasanit. Kjo si një mënyrë edhe për të njohur terrenin ku do të kandidojë, por edhe për tu promovuar te votuesit elbansallit. Ndërkohë që një garë interesante pritet edhe në kryeqendrën e veriut, Shkodrën. Ndërsa demokratët pritet të rikandidojnë sërisht Voltana Ademin, socialistët pritet t'i përgjigjen atyre në këtë garë po me një kandidatë femër. Burime nga PS konfirmojnë se ajo do jetë, ish-zëvendëskryeministria Senida Mesi. Ndërkohë në Fier pritet të rikandidojë Armando Subashi, në Lezhë pritet të kandidojë Pjerin Ndreu, në Vlorë Dritan Leli, në Gjirokastrë Flamur Golemi, në Malësi të Madhe Tonin Marinaj, në Librazhd Kastriot Gurra, në Korçë pritet të rikthehet Niko Peleshi, në Berat Ervin Dema dhe në Lushnjë Tatjana Pirro.



Kryeministri Edi Rama dhe kryebashkiaku i Fierit, Armando Subashi

### KANDIDATËT

Në Fier pritet të rikandidojë Armando Subashi, në Lezhë pritet të kandidojë Pjerin Ndreu, në Vlorë Dritan Leli, në Gjirokastrë Flamur Golemi, në Malësi të Madhe Tonin Marinaj, në Librazhd Kastriot Gurra, në Korçë pritet të rikthehet Niko Peleshi, në Berat Ervin Dema dhe në Lushnjë Tatjana Pirro.

### Kryebashkiakët socialistë që kandidojnë për një mandat tjetër

Përveç Erion Veliajt, një nga emrat më të sigurt që pritet të rikandidohet për një mandat tjetër është ai i kryetarit të Bashkisë së Fierit, Armando Subashi. Mes socialistëve, emri i Subashit vlerësohet si një nga kryebashkiakët më të mirë socialistë dhe që ka sjellë një ndryshim të konsiderueshëm në bashkinë që drejton. Një emër tjetër që pritet të rikandidohet është edhe ai Tonin Marinajt për Bashkinë e Malësisë së Madhe, i cili së bashku me Subashin dhe Veliajn ishin tre kryebashkiakët më të vlerësuarit në raportin e Asamblesë Kombëtare të disa muajve më parë. Një rikandidim pritet edhe për kryetarin e Bashkisë së Vlorës, Dritan Leli, i cili, në fakt, ka drejtuar bashkinë nën hijen e kryeministrit Edi Rama. Po ashtu i sigurt bëhet edhe rikandidimi i Kastriot Gurrës për Bashkinë e Librazhdit.

### KUSH JANË KANDIDATËT E

- Tiranë - Erjon Veliaj
  - Durrës - Adrian Çela
  - Elbasan - Gledian Llatja
  - Korçë - Sotiraj Filo
- ose Niko Peleshi
- Shkodër - Senida Mesi
  - Gjirokastrë - Flamur Golemi
  - Fier - Armando Subashi
  - Vlorë - Dritan Leli
  - Lushnjë - Tatjana Pirro
  - Librazhd - Kastriot Gurra
  - Berat - Ervin Dema
  - Lezhë - Pjerin Ndreu
  - Malësi e Madhe - Tonin Marinaj
  - Kukës - Safet Gjici
  - Himarë - Jorgo Goro

### TIRANA

Kryeqyteti padyshim do të përbëjë dhe garën më të rëndësishme elektorale, jo vetëm për shkak se përfshin gati 1/3 e popullsisë së gjithë Shqipërisë, por edhe rëndësisë që merr në debatin politikë fitorja ose humbja e kësaj bashkie. Kështu nga njëra anë demokratët kanë hedhur në debat publik disa kandidatë, ku më e favorizuara deri më tani duket Jorida Tabaku, e cila në zgjedhjet e fundit për strukturat e reja arriti të ishte e vetmja kandidatë femër që u zgjodh me vota direkte anëtare kryesie. Ndërkohë që në kampin socialist dilemat janë më të pakta në këtë drejtim, pasi rikandidimi i Veliajt është thuar një gjë e sigurtë. Vetë kryeministri Edi Rama duke folur dy ditë më parë në prezantimin e projektit të kampusit universitar, u shpreh se ai do të përfundojë brenda mandatit tjetër të kryetarit të bashkisë, duke konfirmuar në një farë mënyre se Veliaj do jetë edhe për një mandat tjetër kryetar i Bashkisë së Tiranës. Gjithsesi në media ka qarkulluar edhe emri i ministres së Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu.

### DURRËS

Ndërkohë që interesante paraqitet gara edhe për bashkinë e dytë më të rëndësishme në vend, atë të Durrësit. Në

## Deputetët që mund të lënë mandatin për t'u zgjedhur kryebashkiak

Në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme vendore socialistët pritet të bëjnë dhe disa lëvizje deputetësh për t'i kandiduar për kryetar bashkie. Një nga këto lëvizje është edhe ajo Pjerin Ndreu, i cili pritet të lërë mandatin e deputetit për të kandiduar për kryetar i Bashkisë së Lezhës. Mësohet se për këtë qëllim ai ka bërë edhe lëvizjen e gjendjes civile nga Tirana në Lezhë, ku edhe tashmë rezultojnë si votues. Një tjetër deputet që pritet të lërë mandatin për të konkurruar për kryetar bashkie është Flamur Golemi. Burime nga PS bën me dije se ai me shumë mundësi do të rikthehet në Gjirokastrë për të konkurruar për kryetar të kësaj bashkie, ndërsa vlerësohet si një nga figurat e reja dhe premtuese të PS-së për



këtë zonë. Gjithsesi në strukturat partiake të Gjirokastrës flitet edhe për emrin e prefektit Astrit Aliaj dhe ai i ish-ministres së Kulturës, Mirela Kumbaro. Në grupin socialist flitet edhe për një lëvizje surprizë të Niko Peleshit drejt Bashkisë së Ko-

rçës. Sipas burimeve nga PS mësohet se Peleshi mund të rikthehet të rikandidojë në Korçë për të zëvendësuar Sotiraj Filon, i cili duket se do largohet për shkaqe shëndetësore. Një tjetër largim nga grupi socialist përfillet se mund të jetë edhe ai i Tatjana Piro, e cila mund të lërë mandatin për të kandiduar për Bashkinë e Lushnjës. Ndërkohë që gjithnjë e më shumë po shkon drejt një kandidimi edhe ish-zëvendëskryeministri i Arsimit, Ervin Dema në Bashkinë e Beratit. Demo prej disa kohësh është stacionuar në Berat ku po punon me strukturat e partisë, çka ka hedhur dyshimin se ai do jetë kandidati i PS-së për këtë bashki ku do duhet të mundë influencën e LSI-së.

## PROTESTA OPOZITA

### Dita e 77 e protestës, Balliu: Rrëzimi i Ramës është domosdoshmëri

Banorët e zonës së Astirit, banesat e të cilëve preken nga projekti i Unazës së Re kanë dalë edhe dje në mbremje në protestë në ditën e 77 të tyre. Ata edhe një herë u shprehën në vendosur që të vazhdojnë betejën e tyre për të mos lejuar zhvillimin e projektit, i cili sipas tyre është korruptiv dhe kriminal. Ata i kërkuar qeverisë që të heqë dorë nga ky projekt, pasi në të kundërt do të përballen me forcën e qytetarëve. Në mbështetje të banorëve ishin edhe deputetët e opozitës. Gjatë fjalës së tij, deputeti i PD, Klevis Balliu u shpreh se java e ardhshme është e rëndësishme, pasi sipas tij



ka ardhur koha që qytetarët të bashkohen për të rrëzuar këtë qeveri. "Çdo ditë që ne dalim këtu neve na shtohen mbështetësit dhe qytetarët e

ndershëm që janë kundër vjedhjes. Edi Rama anuloi projektin se revoltat që do shohësh në Shqipëri do ta bëjnë revoltën në Francë lule

përballë asaj që do shohësh ti në Shqipëri. Shtëpitë janë tuajat dhe tuajat do të mbeten do apo nuk do Edi Rama. Rrëzimi i Edi Ramës është domosdoshmëri kombëtare. Java që do vijë do jetë javë e rëndësishme për të gjithë ne. Ka ardhur koha që qytetarët të marrin atë që u takon. Ka ardhur koha që politika të degëjoj qytetarët dhe jo interesat e saj. Të bashkoemi të gjithë për të rrëzuar këtë qeveri. Qytetarët nuk kanë më rrugë tjetër përveç revoltës", u shpreh deputeti i PD, Klevis Balliu.



Gjatë një seance parlamentare

Kryetarja e LSI-së zhvilloi dje një takim me strukturat e partisë në Skrapar

## Kryemadhi: Në qershor edhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare

"Sot Shqipëria ka rënë në duart e një grupi kriminal"

Opozita është e bindur se në qershor vendi do të mbajë jo vetëm zgjedhjet vendore, por edhe ato të parakohshme parlamentare. Nga Skrapari, kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi, gjatë një takimi me strukturat e partisë deklaroi se vendi do të shkojë në zgjedhje parlamentare, të cilat sipas saj ka gjasë që të mbahen në një ditë me ato lokale, të cilat janë dekretuar nga Presidenti Ilir Meta me 30 qershor: "Në fakt, kemi një datë të zgjedhjeve lokale të dekretuara. Por nuk do të jenë vetëm zgjedhje lokale. Do të jenë zgjedhje lokale dhe zgjedhje të përgjithshme, sepse shqiptarët nuk mund të pranojnë që të qeverisen nga një qeveri që ka grabitur mandatet politike të saj në parlament dhe nga një qeveri e cila mandatet e saj i ka të blera me paratë e drogës dhe të kimit të organizuar", - tha e bindur Monika Kryemadhi. Kryemadhi theksoi se sot shqiptarët duhet të ngrihen dhe të mbrojnë të ardhmen e tyre që sipas saj është marrë peng nga një grup kriminal që mendon vetëm si të vjedh paratë e shqiptarëve. "Sot nuk jemi thjesht në një situatë normale, nuk jemi në kushte normale, jemi në kushtet emergjencës, për sa



Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi

i përket situatës në të cilën ndodhet Shqipëria. Siç ndodhet Shqipëria ndodhet dhe Skrapari, ndoshta për shkak të qëndrës dhe për shkak të pozicionimit të tyre politikisht. Sot Shqipëria ka rënë në duart e një grupi kriminal dhe oligarkësh, të cilët çdo ditë e më shumë mendojnë sesi të vjedhin para nga buxheti i shtetit, sesi të varfërojnë shqiptarët dhe sesi të pasurohen vetë ata duke çuar paratë në xhepin e Kryeministrit", - tha kryetarja e LSI-së. Në fjalën e saj, kryetarja e LSI-së u shpreh se ka ardhur koha që populli duhet t'i japë një mesim të qartë politikës shqiptare, jo për rrota-

cion, por si një shenjë dhe kërkesë llogarë për premtimet që ata bëjnë. "Duam t'i japim mesim politikës shqiptare që ai që jep premtime duhet ta mbajë ose në të kundërt meriton të tërhiqet zvarrë. Mos ndaloni duke kontaktuar vëllezërit, familjarët dhe miqtë tuaj. Nuk është nevoja të bëjmë rrotacion politik, por duhet të organizohemi duke mos lejuar blerjen e varfërisë së familjeve shqiptare, sepse duke bërë këtë do të na blejnë edhe shpirtin. Ta bëjmë Shqipërimë si shtëpinë tonë, kjo do të thotë të veprosim duke rrëzuar këtë klikë oligarkësh", - shtoi Kryemadhi. Kryetarja e LSI-së

akuzoi, gjithashtu, kryeministrin se nëpërmjet emërimeve në prokurori, KLP e gjykatat, ka marrë peng drejtësinë në vend. "Po pse opozita garanton procesin e zgjedhjeve, apo është qeveria ajo që e garanton luftën kundër kimit dhe korruptionit? Pse opozita e ndalon luftën kundër kimit dhe korruptionit? A e zgjidhi Edi Rama prokuroren me 69 vota në parlament? E ka prokurori, gjykata çdo gjë. A ka kunatin e një prej deputeteve të PS që drejton KLP? Le ta drejtojnë, le ta bëjnë luftën kundër kimit dhe korruptionit", - u shpreh Kryemadhi. Gjithashtu, ajo theksoi se së fundmi edhe Brukseli zyrtar i ka bërë të qartë qeverisë se është ajo përgjegjëse për bllokimin e reformave. "Nga Brukseli degjohim një rrufe në qiell të hapur; degjohim se si Komisioneri Hahn shprehet se "Rama ka mbajtur peng reformat". Kemi përballë një sfida: Të Rrëzohet Edi Ramën. Kudo që shkel, degjoj se edhe socialistët në ndershëm janë të merrtur me Rilindjen. Kur nuk ka socialist të ndershëm që suporton këtë njeri, tani duhet thënë se kushtet janë pëjkur. Do të dalim në rrugë dhe do ta rrëzojmë Edi Ramën", - tha ajo.

### Meta: Durrësi xhevahir i historisë, mbrojtja e tij prioritet madhor

Presidenti i Republikës, Ilir Meta priti në një takim kryesinë e shoqatës "Durrësi" të përfaqësuar nga intelektualët Shpëtim Metani, Lumturi Ngjala, Agim Shehi, Rifat Bilali dhe Gjon Huli. Pasi u njoh me aktivitetin e kësaj shoqate, Presidenti Meta vlerësoi lart kontributin e saj për mbrojtjen dhe promovimin e vlerave qytetare e patriotike, trashëgimisë së pasur historike, arkeologjike dhe kulturore të kësaj treve. "Durrësi është një xhevahir i çmuar i historisë së Shqipërisë, për vlerat e spikatura patriotike, intelektuale, artistike e kulturore, si vatrë e rëndësishme e atdhedashurisë dhe dijes nga ku kanë dalë personalitete të shquara në të gjitha fushat. Por veçanërisht për trashëgiminë e pasur, autentike dhe të jashtëzakonshme arkeologjike, që e dallojnë nga trevat e tjera duke e kthyer në një atraksion të rëndësishëm turistik. Mbrojtja dhe promovimi i këtyre vlerave që na bëjnë krenarë si shqiptarë duhet të jetë një prioritet madhor për të gjithë ne", - tha Meta. Gjithashtu, Meta zhvilloi një bisedë miqësore me personalitete të shquara drejtuese të klubit patriotik "Bashkësia dibrane", ku morën pjesë kompozitori i mirënjohur dhe "Nderi i Kombit", Agim Krajka dhe Mjeshtri i Madh, Bujar Kapexhiu. Presidenti Meta duke çmuar lart kontributin dibranë, cilësitë e spikatura njerëzore, atdhedashurinë dhe kontributin e madh të brezave të tërë të kësaj treve për pavarësinë dhe forcimin e identitetit kombëtar, vlerësoi rolin e kësaj shoqate për ruajtjen e promovimin e vlerave të trashëgimisë së pasur historike e kulturore të Durrësit.

### Vasili: Shqiptarët kanë humbur shpresën për shkak të Edi Ramës

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili është shprehur dje se Shqipëria dhe shqiptarët kanë humbur shpresën si rrjedhojë e keqqeverisjes së socialistëve. Nëpërmjet një komentari në rrjetet sociale Vasili theksoi se ajo që është edhe më shqetësuese është se deprimimi dhe humbja e thellë e shpresës nga shoqëria po kalohet në mënyrë vulgare nga shefi i qeverisë përmes batutave bajate. "Shqipëria po vuan një skizofreni ekonomike, sociale dhe morale, që lidhet me antistandardin skizoid Edi Rama. Varfëria ekstreme, që largon qindra mijë ra shqiptarë po shtet si normalitet nga skizofrenia e Edi Ramës. Deprimimi i rëndë shoqëror dhe humbja e shpresës, po trajtohen me vulgaritet të pashembullt qeveritar përmes batutash ordinare dhe një gjuhe rrugësh e bordellosh që vetëm një skizofren si Edi Rama mund ta përdorë. Qeverisja e tërë është përfshirë nga stuhira skizofrenike, që po çojnë drejt qorrsockakut shkaterërrimtar ekonomik të Shqipërisë", - shkroi Vasili.



Opozita pritet të jetë e pranishme në sallë sot kur të votohen dekretet e Metës

# Hapet sot sesioni parlamentar, votohet Rama si ministër i Jashtëm

Nesër Rama duhet të shkojë në Presidencë për t'u betuar

Nis sot sesioni i katërt i Legjislaturës së nëntë të Kuvendit të Shqipërisë. Por seanca e sotme nuk do jetë vetëm ceremoniale, pasi në të pritet të votohen edhe dy dekretet e fundit të Presidentit Ilir Meta për të kompletuar kështu ndryshimet në qeveri. Kështu, në seancën e sotme do të votohet dekreti për shkarkimin e Ditmir Bushatit nga detyra e ministrit të Jashtëm si dhe dekreti tjetër, ai për emërimin në vend të tij të Edi Ramës si shef i diplomacisë shqiptare. Nisur nga fakti se në këtë seancë do jetë edhe votimi i dekretit për emërimin e Edi Ramës si ministër i Jashtëm, burime nga opozita kanë bërë me dije se ajo do jetë sot e pranishme në sallë. Gjithsesi, para seancës pritet të zhvillohet edhe një mbledhje e grupit parlamentar, ku pritet të merret edhe vendimi final për këtë seancë. Ndërkohë që menjëherë pas votimit të sotëm, kryeministri Edi Rama do i duhet që të paraqitet në Presidencë për t'u betuar para Metës për marrjen e detyrës së re. Ndëonëse bëhet fjalë për një akt formal procedural, ky do jetë momenti i parë i ballafaqimit të Ramës me Metën, pas akuzave e kundërakuzave që kanë shkëmbyer gjatë javëve të fundit lidhur me debatin për dekretimin e ministrave.



Kryeministri Edi Rama

**BETIMI**

Menjëherë pas votimit të sotëm, kryeministri Edi Rama do i duhet që të paraqitet në Presidencë për t'u betuar para Metës për marrjen e detyrës së re. Ndëonëse bëhet fjalë për një akt formal procedural, ky do jetë momenti i parë i ballafaqimit të Ramës me Metën, pas akuzave e kundërakuzave që kanë shkëmbyer gjatë javëve të fundit lidhur me debatin për dekretimin e ministrave.

**Ndryshimet në qeveri, PS mban ende në faqe ministrat e vjetër**

Ndonëse ministrat e rinj kanë marrë detyrën që prej javës së shkuar, Partia Socialiste nuk e ka bërë ende rifreskimin e faqes së saj zyrtare në internet. Ende në të janë të afishuar ministrat e vjetër. Nuk bëhet fjalë vetëm për ish-ministrat që lanë detyrën një javë më parë, por në faqen zyrtare të PS-së rezultojnë ende si ministër Fatmir Xhafaj, i cili ka lënë detyrën gati 2 muaj më parë. Ndërkohë që vetë qeveria u tregua shumë e shpejt në rifreskimin e saj dhënave të faqes së saj zyrtare, pasi menjëherë sapo ministrat e rinj bënë betimin para presidentit, ajo bëri dhe ndryshimet e nevojshme në faqe.

**Akuzohen se po i japin territore Serbisë, Rama takon Thaçin**

Në kulmin e akuzave se së bashku po planifikojnë shkitjen e territoreve të Kosovës Serbisë, kryeministri Edi Rama dhe presidenti kosovar Hashim Thaçi kanë patur dhe një takim informal. Lajmi u konfirmua nga vetë shefi i qeverisë, i cili shpërndau dhe një foto nga ky takim në "Instagram". Të dy politikanët janë shfaqur duke konsumuar kafe në një bar, ndërsa në foto duket qartë kujdesi dhe përqendrimi që tregon kryeministri Rama ndaj presidentit Thaçi. Nuk dihen detaje se çfarë është diskutuar mes tyre, por takimi është zhvilluar gjatë një vizite që Thaçi ka bërë në Shqipëri. Rama në Shqipëri dhe Thaçi në Kosovë janë akuzuar kohët e fundit se po mbështesin arrijten e marrëveshjes së shkëmbimit të territoreve mes Kosovës dhe Serbisë. Madje Rama u akuzua se edhe ministrin e Jashtëm Ditmir Bushati e hoqi pikërisht prej faktit se ky i fundit ishte kundër kësaj marrëveshje.



**Denar Biba: S'ka më kohë për teknologjinë dhe depolitizim të komisionerëve**

Përdorimi i teknologjisë në zgjedhjet e 30 qershorit dhe depolitizimi i komisionerëve ashtu siç edhe parashikon drafti ligjor i përgatitur nga socialistët është e pamundur të realizohet më. Kjo pasi nuk ka më kohë fizike, jo vetëm për të miratuar ndryshimet e nevojshme ligjore por edhe për të bërë testimet e nevojshme para aplikimit. Nënkrjetari i KQZ-së, Denar Biba, duke folur për 'Oranews' tha se edhe nëse PD e PS bien dakord për kodin e ri zgjedhor, këto dy veshitja janë të vështira për t'u realizuar. "Kjo jo vetëm që do të kërkojë ndërhyrje në aspektin logjistik, prokurime e kështu me radhë, do të merrnin dhe investim të brendshëm nga KQZ, njohjen me teknologjinë. Nëse do të bëhet ndonjë ndryshim, të bëhet mundësisht nesër, por kohë nuk ka", - tha Biba duke folur për teknologjinë. Ndërkohë që sipas tij as aspekti tjetër që ka të bëjë me depolitizimin e komisionerëve nuk është i mundur që të arrihet. Kjo pasi jo vetëm që mungon konsensusi i palëve, por trupa e komisionerëve jo politikë duhet trajnuar. "Nëse do të depolitizohen komisionerët do të duhet që ata të jenë trajnuar, të certifikuar më parë nga KQZ. Por sa më tepër t'i afrohem datës së zgjedhjeve, aq më e vështirë do të jetë", - tha nënkryetari Denar Biba. Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka nisur përgatitjet për 30 qershorin me kodin e vjetër pasi, ashtu siç shprehet nënkryetari i këtij Komisioni, nuk ka kohë për të humbur.

**REFORMA**

Vec votimit të dekretive Kuvendi do të votojë edhe kalendarin e punimeve, ndërsa deputetët do të njihen edhe me projektligjet e depozituara. Një nga sfidat e kësaj legjislaturo do jetë padyshim miratimi i reformës zgjedhore, megjithëse tashmë gjasat që kjo gjë të realizohet janë të pakta. Socialistët kanë depozituar në Kuvend një projektligj të plotë për të amenduar Kodin Zgjedhor, por ai nuk ka ardhur si produkt i një diskutimi të gjithanshëm, por si propozim i njëanshëm i deputetëve të PS-së. Ndaj opozita e ka kundërshtuar atë draft si të papranueshëm, ndërsa në mbledhjen e fundit të Konferencës së Kryetarëve ajo kërkoi me forcë që të shtyhet edhe një herë afati i komisionit të posaçëm të reformës zgjedhore. Kërkesë

kjo që u refuzua nga socialistët, të cilët bënë të ditur se nuk mund të shtyhet afati i një komisioni që i ka mbaruar mandati prej një kohe të gjatë. Gjithsesi kryeparlamentari Gramoz Ruci u shpreh të premtën e shkuar se drafti i paraqitur nga socialistët nuk mund të hyjë në procedurë parlamentare, nëse më parë

nuk merr konsensusin e komisionit parlamentar për reformën zgjedhore. **KOMISIONET** Ndërkohë që ndryshimet në qeveri kanë sjellë si pasojë edhe nevojën për disa ndryshime në drejtimin e komisioneve parlamentare. Kjo për vetë faktin se disa nga kryetarët apo nënkryetarët e komisioneve parlamentare

tashmë janë bërë ministra. Ndaj socialistët pritet t'i propozojnë Kuvendit edhe ndryshimet e nevojshme. Kështu mësohet se Eduard Shalasin në krye të Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese pritet ta zëvendësojë Niko Peleshin, ndërsa Blerina Gjylahmeti pritet të zëvendësojë Bledi Çuçin në pozicionin e bashkëkryetarit të Komisionit të posaçëm të Reformës Zgjedhore. Ndërkohë që postin tjetër të Bledi Çuçit, si zëvendëskryetar i Komisionit të Integritetit pritet ta marrë Ditmir Bushati ose Ervin Bushati. Ndërsa Elisa Spiropalin te Komisioni i Shëndetësisë pritet ta zëvendësojë Klodi-ana Spahiu.

**Shoqëria permbarrimore JUSTITIA**

Shoqëria permbarrimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e PARE , për shitjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vënë hipoteke NBG BANK/ABI BANK, me këto të dhëna: Nr. 1/387-N1, ZK, 8562, VOL 30, FAO, 91 e ligji rregull me sip. 109 m2 ndodhur në adresën Rruga "Fuat Babari", Korçë në pronësi të Pandell Bonja. Në vlerën 69.740 EUR (gjatëditja e nentë mijë e shtatëdhjetë e gjashtëdhjetë ) EUR Nr. 1/387-N3, ZK, 8562, VOL 30, FAO, 91 e ligji rregull me sip. 89,2 m2 ndodhur në adresën Rruga "Fuat Babari", Korçë në pronësi të Pandell Bonja. Çmimi me të cilin fillon ankand është në vlerën 57.088 EUR (pesëdhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e tetë) EUR. Ankand zhvillohet në datën 04.02.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbarruesit gjyqësor, me Adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

Shoqëria permbarrimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e TRETË , për shitjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vënë hipoteke NBG BANK/ABI BANK, me këto të dhëna: Lloji i pasurisë Are+ Trull (magazine dy kate) me sip. arë 3000 m2 /trull 1661/ndritësë 234,9, me nr.pasurie 58/9 vol 8 fq78, zk.1475, Derven, KRULJE në pronësi të Haki Ahmet MAVRIQI Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 60.480 (gjashtëdhjetë mijë e katërdhjetë ditë) EUR Ankand zhvillohet në datën 15.02.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbarruesit gjyqësor, me Adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890



Kujtohet sot 8-vjetori i 4 vrasjeve në bulevardin "Dëshmorët e Kombit"

# 21 janari, familjarët e Ziver Veizit, statusi i dëshmorit s'është drejtësi

## "Kemi shpresë te SPAK dhe Byroja e Hetimit"

Në 8 vjetorin e ngjarjes së 21 janarit, familjarët e 4 të viktimave që mbetën të vrarë gjatë protestës së opozitës së atëhershme kërkojnë sërish drejtësi. Të zhgënjyer nga shteti dhe në mënyrë të veçantë nga institucionet e drejtësisë, familjarët e Ziver Veizit, një prej të vrarëve në 21 janar të 2011, thonë se edhe sot, 8 vite më pas, drejtësia nuk është vënë në vend dhe ende nuk është bërë asgjë për zbardhjen e ngjarjes. Për motrën e Ziverit, reforma në drejtësi nuk do të mund të quhet e tillë nëse nuk zbardh ngjarjen e 21 janarit dhe vënien para drejtësisë të vrasësve të 4 personave. "Po bëhen 8 vite nga vrasja dhe nuk ka asnjë ndryshim nga drejtësia, pasi fajtorët nuk janë dënuar. Drejtësia nuk ka vajtur në vend, por kemi shpresë te SPAK dhe Byroja e Hetimit. Dënimi i autorëve do na lehtësonte humbjen e vëllait tonë", thotë motra e Ziver Veizit, Trendafilë Mahmuti për News24. Ajo ka vlerësuar edhe ligjin që u miratua për dhënien e statusit të dëshmorëve 4 viktimave të 21 janarit, por sipas saj kjo do të ishte vetëm një lehtësim moral, por jo vendosje e drejtësisë për atë që ndodhi në atë ngjarje. "Moralisht na lehtëson shpallja dëshmor e vëllait. Si çdo vit do të shkojmë tek vendi ku është vrarë për ta përkujtuar", tha më tej motra e Ziver Veizit.



Motra e Ziver Veizit, Trendafilë Mahmuti



Vëllai i Ziverit, Caush Veizi

### DREJTËSIA

"Çdo vit presim që dikush të dënohet për vrasjen e vëllait. Me aq sa dimë ne për këtë çështje s'po behet asnjë hetim. Edhe nëse i shpallin dëshmor, ne serish do kërkojmë vrasësit para ligjit."- tha i vëllai i Ziverit

uran Deda. Ndërkohë që në fshatin Zenelaj, vendlindja e njërit prej të vrarëve të 21 janarit, Ziver Veizit, familjarët e tij do të zhvillojnë prej të një ceremoni mortore përkujtimore private. 21 janari i 2011 do të mbetet një ndër ditët më dramatike në historinë e demokracisë shqiptare. Ziver Veizi, Faik Myrtaj, Hekuran Deda dhe Aleks Nika u vranë në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" gjatë protestës së Par-

isa si përgjegjës kryesor. Ndërkohë që Gjykata e Tiranës, dënoi ish-komandantin e Gardës Andrea Prendin dhe gardistin Agim Llupo për ngjarjen. Ndërkohë

**MOTRA E ZIVERIT**  
"Po bëhen 8 vite nga vrasja dhe nuk ka asnjë ndryshim nga drejtësia, pasi fajtorët nuk janë dënuar. Drejtësia nuk ka vajtur në vend, por kemi shpresë te SPAK dhe Byroja e Hetimit. Dënimi i autorëve do na lehtësonte humbjen e vëllait tonë", thotë motra e Ziver Veizit

### Qeveria dhe grupi i PS ceremoni në kujtim të 4 të vrarëve

A shtu siç e kanë bërë traditë çdo 21 janar, socialistët do të kujtojnë sot viktimat e protestës së ndodhur 8 vite më parë në bulevardin "Dëshmorët e Kombit". Burime nga mazhoranca bën me dije dhe se edhe sot do të organizohet një ceremoni e posaçme nga qeveria dhe grupi parlamentar. Pritet që kryeministri Rama të zhvillojë një takim me familjarët e 4 të vrarëve, ndërsa të pranishëm përveç anëtarëve të qeverisë, pritet të jenë dhe anëtarë të grupit parlamentar të Partisë Socialiste. Ndërkohë që më pas familjarët dhe përfaqësuesit e mazhorancës do të zbrasin në bulevard për të nderuar 4 viktimat me një minutë heshtje dhe për të vendosur më pas lule në vendet ku qëndrojnë pllakat përkujtimore të Ziver Veizit, Hekuran Dedis, Aleks Nikës dhe Faik Myrtajt. Të 4 të vrarët e 21 janarit në bazë të ligjit të miratuar nga Kuvendi në fund të dhjetorit janë shpallur dëshmorë.

tisë Socialiste, asokohe në opozitë. Menjëherë pas vrasjeve, socialistët e vlerësuan ngjarjen si krim shtetëror, ku akuzuan kryeministrin e kohës Sali Ber-

isha si përgjegjës kryesor. Ndërkohë që Gjykata e Tiranës, dënoi ish-komandantin e Gardës Andrea Prendin dhe gardistin Agim Llupo për ngjarjen. Ndërkohë

525 mijë euro u ndanë me vendim qeverie për secilin nga 4 familjet e të vrarëve, ndërsa Garda e Republikës paditi ish-drejtuesit e saj për vrasjet.



**FORCIMI I POLICIMIT NË KOMUNITET NË SHQIPËRI**

Thirrje për projekt-propozime

"Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri", program që financohet nga Qeveria Suedeze dhe që asiston zbatimin e reformës së policimit në komunitet në Shqipëri, shpall **Thirrjen Nr.3 Për Aplikime**.

Organizata Joffitimpurisë (OJF), konsorciume dhe Organizata me Bazë Komunitare të cilët dëshirojnë të aplikojnë për grante nën Skemën e Grantëve të këtij Programi, janë të ftuar të paraqesin projekt-propozime në kuadër të Thirrjes Nr.3, e cila do zbatohet në qarqe Vlorë, Lezhë, Korçë dhe Elbasan. Inkurajohen të aplikojnë organizata me seli në zonat ku parashikohet të zbatohet thirrja dhe projekt-propozimet të përfshijnë jo vetëm Bashkitë Qendër Oarku (Vlorë, Lezhë, Korçë dhe Elbasan) por edhe bashkitë e tjera përbrëshe (psh. Sarandë, Mirëditë, Kolonjë etj.), apo njësi administrative të tyre.

Për organizatat të cilat nuk kanë seli në këto zona, si kusht detyrues për aplikim në këtë thirrje, është bashkë-aplikimi me një organizatë lokale/aktivitet lokalë duke nënshkruar paraprakisht një marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e projektit.

Programi do të ofrojë tre lloj grantesh:

- Grantë deri në **15,000 €**
- Grantë deri në **10,000 €**

Këto grante do të jepen për projekt-propozime që synojnë a) fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile për të mbështetur krijimin dhe ngjirjen e kaqelitëve të koalicioneve me bazë komunitare me synim përmirësimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit e vazhdueshmërisë me Policinë së Shtetit dhe komuniteteve vendore si dhe ri-njësimit të ndërsjellë dhe; b) Përmirësimin e ndërrimit mes Policisë së Shtetit dhe aktorëve të tjerë lokalë, anëtarë të mekanizmave lokale të referimit, për ri-njësimit dhe cilësisë së masave parandaluese dhe ri-njësimit të cilësisë së shërbimeve ndaj rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Afati kohor për zbatimin e projektit: deri në 18 muaj

Grantë deri në **5,000 €** të cilat do të mbështesin projekt-propozime që synojnë krijimin dhe konsolidimin e partneriteteve ndërmjet policisë, institucioneve vendore dhe komuniteteve duke pasur në fokus: ri-njësimit në fushën e çfarëje së konflikteve, ndërrimit të informimit, pasqartë e përdorimit të drogave dhe substancave narkotike, sigurinë në trafikun rrugor, bulizmin dhe krimin kibernetik, trafikimin e gënjeshtrës, krimet homologjike, ekstremizmin e dhunshëm, etj; me theks të veçantë në masat parandaluese. Afati kohor: deri në 7 muaj

Projekt-propozimet duhet të plotësohen sipas Formularit të Aplikimit dhe Udhëzuesit për Aplikime. Të dy këto dokumente mund të konsultohen / shkarkohen nga linku <http://www.cp-project.al/skema-e-granteve/>

Aplikimi dhe dokumentet mbështetëse (lista e të cilave gjenden tek Udhëzuesi për Aplikime, 5.2.5 Kriteret e Vlerësimit) duhen dorëzuar deri në datën 21 Shturt 2019, ora 17:00. Për më shumë detaje referohuni në: <http://www.cp-project.al/>



**Tirana International Airport**  
Nënë Tereza

**TENDER NOTIFICATION**

**SUPPLY OF STAFF UNIFORMS**  
**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k is looking to contract a company for the Supply of Staff Uniforms for Tirana International Airport for a period of two years with the possibility of renewal.

In order to obtain the necessary information for participating in this process, the interested parties need to write an e-mail to the following address: [kzoraqi@tirana-airport.com](mailto:kzoraqi@tirana-airport.com); [srada@tirana-airport.com](mailto:srada@tirana-airport.com); [ialimema@tirana-airport.com](mailto:ialimema@tirana-airport.com); [apalushi@tirana-airport.com](mailto:apalushi@tirana-airport.com) specifying, request for information for "Supply of staff uniforms".

The necessary instructions are delivered free of charge, electronically through e-mail.

This tender will be organized in two phases:

1. In the first phase companies will need to present similar works through uniform samples performed for other companies, letter of references and also a sample of the proposed materials.
2. In the second phase short listed companies will need to submit their financial offer together with the sample for Tirana International Airport.

Offers needed to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked 'Supply of Staff Uniforms for Tirana International Airport'.

The address for submission of offers is:

**Tirana International Airport sh.p.k**  
**Procurement Department**  
**Administration Building**  
**Rinas, Tirana**  
**Albania**

The deadline for the submission of samples at the above address is **16:00 hrs. on 25 January 2019**.

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:  
[kzoraqi@tirana-airport.com](mailto:kzoraqi@tirana-airport.com)  
[srada@tirana-airport.com](mailto:srada@tirana-airport.com)  
[ialimema@tirana-airport.com](mailto:ialimema@tirana-airport.com)  
[apalushi@tirana-airport.com](mailto:apalushi@tirana-airport.com)

## PENSIONI FALIMJAR PËRFITUESIT

Instituti i Sigurimeve Shoqërore: Kujdes, ja rastet kur pagesa mund të ndërpritet

# Cilat janë 5 kategoritë që përfitojnë pension familjar

*Kriteret dhe dokumentacioni që nevojitet*

Voltiza Duro

Bazuar në ligjin "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", qytetarët që plotësojnë kriteret e përcaktuara mund të përfitojnë pension familjar. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot kategoritë përfituese, kushtet si dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë kandidatët e interesuar.

### KATEGORITË PËRFITUESE

Përkatesisht janë 5 kategori që mund të marrin pagesën e pensionit familjar. Këtë të fundit mund ta përfitojnë të gjithë jetimët që ishin në ngarkim të personit që vdiq dhe janë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, të cilët studiojnë apo janë të paaftë për punë. Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se në momentin që i/e veja martohen sërisht, e humbasin të drejtën e përfitimit të pensionit familjar. Ndërsa në të gjitha ato raste kur e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar dhe përfitues është vetëm një jetim, masa e pensionit për jetimin është 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri. Gjithashtu, përcaktohet edhe moshë kur përfitohet pensioni familjar nga i/e veja. Pension familjar mund të përfitojë e veja që është mbajtëse e një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në moshën 8 vjeç; që nuk është e aftë të punojë dhe që ka mbushur moshën 55 vjeç. Gjithashtu, nga kjo kategori pensioni përfiton edhe burri i ve, kur është mbajtës i një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në moshën 8 vjeç, që është i paaftë për punë dhe që ka mbushur moshën 60 vjeç. Të gjithë ata jetimë që ishin në ngarkim të personit që vdiq dhe janë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, të cilët studiojnë apo janë të paaftë për punë mund të përfitojnë pension familjar. "Një kategori tjetër që plotëson kushtet, janë edhe prindërit, kur kanë arritur



Foto ilustruese

moshën 65 vjeç ose janë të paaftë për punë, prindërit e prindërve, njerku e njerka, kur nuk kanë persona që detyohen t'i mbajnë, nëse provohet se ata jetonin në të njëjtën familje me atë që vdiq, jo më pak se një vit para momentit të vdekjes dhe kanë arritur moshën 65 vjeç, ose janë të paaftë për punë", bën me dije Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Sipas këtij të fundit edhe nipërit e mbesat, kur janë në ngarkim të atij që vdiq dhe bënin pjesë në të njëjtën familje me të, trajtohen si jetimë dhe mund të marrin pension familjar. Në momentin që i/e veja martohen sërisht, e humbasin të drejtën e përfitimit të pensionit familjar.

### DOKUMENTACIONI

Të gjithë ata individë që do të aplikojnë për të fituar të drejtën e përfitimit të pensionit familjar, përveç kërkesës, duhet të dorëzojnë edhe dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin. 'Gazeta Shqiptare' publikon sot skedën e plotë informative për të marrë këtë pagesë si dhe kërkesën që duhet të bëjnë paraprakisht të interesuarit. Respektivisht individët duhet të

paraqesin certifikatën e gjendjes familjare, fotokopjen e letrës së njoftimit elektronik për kërkesin, ose përfituesit e tjerë, si dhe certifikatën e vdekjes së të ndjerit në të cilën duhet të jetë shënuar edhe shkaku i vdekjes. Gjithashtu, aplikuesi për pension familjar duhet të dorëzojë edhe dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës, si librezë e punës apo vërtetimi për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj. Bashkëngjitur dokumentacionit të mësipërm, duhet të dorëzohen edhe dokumentet që vërtetojnë të qenët në ngarkim të të ndjerit si dhe: vërtetimi i vazhimit të shkollës për jetimët që kanë mbushur moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar, vërtetimi që në ngarkim të të vdekurit ishte një i ve, që mban një fëmijë deri në moshën 8 vjeç, vërtetimi për personin e ve, që është kërkuar për punë, vendim i KMCAP-it për paaftësinë në punë të personave të familjes në ngarkim të të siguruarit të vdekur, kur ata janë në moshë pune etj. Nënvojzë se në kërkesën për pension familjar, jetimi që

### PENSIONI FAMILJAR

Pensionin familjar mund ta përfitojnë të gjithë jetimët që ishin në ngarkim të personit që vdiq dhe janë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, të cilët studiojnë apo janë të paaftë për punë. Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se në momentin që i/e veja martohen sërisht, e humbasin të drejtën e përfitimit të pensionit familjar.

ka moshën ligjore për t'u punësuar; kur nuk vazhdon shkollën, duhet të paraqesë vërtetim nga Zyra e Punës. Edhe vërtetimi i pagës duhet të përshihet në dosjen e dokumenteve si dhe vërtetimi i pagës




Foto ilustruese

### 5 KATEGORITË PËRFITUESE

- E veja që mban një fëmijë deri në 8 vjeç; nuk është e aftë të punojë dhe që ka mbushur 55 vjeç.
- Burri i ve, që mban një fëmijë deri në 8 vjeç; nuk është e aftë të punojë, ka mbushur moshën 60 vjeç.
- Jetimët e moshës 18-25 vjeç që studiojnë apo janë të paaftë për punë.
- Prindërit, kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paaftë për punë.
- Nipërit e mbesat, kur janë në ngarkim të atij që vdiq dhe bënin pjesë në të njëjtën familje me të.

mesatare neto, për vitin e fundit të punës. Ndërsa të gjithë ata persona që përfitojnë nga ligji "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve Politikë" duhet të dorëzojnë

vërtetimin e gjendjes gjyqësore mbi kohën e vuajtjes së dënimit, çdo dokument tjetër që vërteton të qenët në punë dhe vërtetimin mbi faktin e dënimit për motive politike dhe kohën e vuajtjes së tij.



Novartis Pharma Services Inc. Tirana-Albania, the Representative Office of the multi-national company, NOVARTIS, the worldwide leader in the pharmaceutical industry, wants to hire a **Product Specialist**.

#### Job Purpose:


To develop, implement and execute marketing mix and tactical plans for a brand or set of brands in the short and long term.

#### Some of his/her qualifications and requirements would be:

- University degree in Medicine, Pharmacy, Biology, Chemistry or other relevant University education.
- At least 5 years of experience in pharma industry (in marketing, sales or medical)
- In-depth understanding of marketing, preferably of pharma marketing
- Ability to build excellent relationship with all key stakeholders with high customer centric mindset
- Ability to generate new ideas/projects customized to the local pharma market
- Ability to manage multiple projects and priorities in a high-volume, fast-paced environment
- Marketing and negotiating skills
- Good communications skills
- Digital literacy and comfortable with technology
- Good command of spoken and written English
- Excellence in implementing planned activities and marketing campaigns adhering to the relevant Codes of Practice/regulations.

The interested candidates are invited to send the CV as well as a Motivational Letter at the e-mail address: [blerta.rambi@novartis.com](mailto:blerta.rambi@novartis.com)  
Deadline 31 January 2018  
We will contact only the selected candidates





25

**VJEÇ, STUDENTËT**

Pensionin familjar mund ta përfitojnë të gjithë jetimët që ishin në ngarkim të personit që vdiq dhe janë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, të cilët studiojnë apo janë të paaftë për punë. Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se në momentin që i/e veja martohen sërish, e humbasin të drejtën e përfitimit të pensionit familjar.

65

**VJEÇ, PRINDËRIT**

"Një kategori tjetër që plotëson kushtet, janë edhe prindërit, kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paaftë për punë, prindërit e prindërve, njerku e njerka, kur nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë, nëse provohet se ata jetonin në të njëjtën familje me atë që vdiq, jo më pak se një vit para momentit të vdekjes dhe kanë arritur moshën 65 vjeç, ose janë të paaftë për punë", - bën me dije ISSH.

50%

**TË MASËS SË PENSIONIT**

Në kushtet kur e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, e përfitues është vetëm një jetim, masa e pensionit për jetimin është 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri, ndërsa kur përfitues janë dy ose më shumë persona dhe e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25%.

25%

**TË PENSIONIT**

Të të ndjerit Kur prindi që jeton është i punësuar, është ekonomiksht aktiv ose merr një pension si të drejtë të tij, fëmija jetim përfiton pension familjar. Në këtë rast, masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25% e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50% e tij. Ndërsa jetimi, i cili humb të dy prindërit, ka të drejtë të marrë një pension jetimi për secilin prej tyre.

Fëmijët jetimë marrin 50% të pensionit që gëzonte i ndjeri

# Si bëhet përlllogaritja e masës së pensionit familjar



Pensionin familjar kon siderohet ai pension që kishte apo i takonte të ndjerit. Në kushtet kur e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, dhe përfitues është vetëm një jetim, masa e pensionit për jetimin është 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri, ndërsa kur përfitues janë dy ose më shumë persona dhe e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25%, por jo më shumë se 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri. Ndërkaq, personi i ve merr 50% të pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri kur është i vetëm, dhe për çdo pjesëtar tjetër merr 25%, me kusht që shuma e pensionit të mos kalojë 100% masën e tij. Vlen të theksohet fakti se shuma e një pensioni familjar nuk duhet të kalojë masën e pensionit që merrte ose do të merrte personi që vdes. Në të gjitha ato raste kur prindi që jeton është i punësuar, është ekonomiksht aktiv ose merr një pension si të drejtë të tij, fëmija jetim përfiton pension familjar. Në këtë rast, masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25% e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50% e tij. Ndërsa jetimi, i cili



humb të dy prindërit, ka të drejtë të marrë një pension jetimi për secilin prej tyre. Në kohën kur përfundon afati i pagesës, përfituesi duhet të bëjë një kërkesë pranë

ALSSH-së së vendbanimit për vazhdimin e pensionit familjar. Bashkëngjitur me kërkesën, i interesuari duhet të paraqesë edhe dokumentacionin përkatës.

**NJOFTIM**

Në datë 05.02.2019 në orën 16.00 në zyrën e përmbasuesit gjyqësor privat Iriza Tereziu PF me adresë në "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njësia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankand për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Truall+Ndertese" me sip. Trualli 220 m2 dhe sip.ndertese 97 m2, me nr.pasurie 11/23, volum 10, faqe 229, zone kadastrale 8503, ndodhur në Lagjia "Jani Vruho", Berat.Crimi në ankand te dyte eshte ne vleren e 2,296,000 (dy milion e dyqind e nentendjete e gjashte mije) lekë.

**DOKUMENTACIONI**

**Dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin:**

- Certifikatë e gjendjes familjare.
- Certifikatë vdekjeje e të ndjerit/të ndjerës.
- Fotokopje e kartës së identitetit për kërkuesin, ose përfituesit e tjerë.

**Dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës:**

- Libreza e punës.
- Vërtetim për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj.
- Vendimi i emërimit në punë, si kuadër në ish-kooperativat bujqësore.
- Vendim gjykate për njohje të vjetërsisë në punë.
- Vërtetim i Degës Ushtarake për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për kërkuesit meshkuj).
- Vërtetim-tip i vjetërsisë në punë për ushtarakët.

**Dokumentet që vërtetojnë të qenit në ngarkim të të ndjerit/ndjerës:**

- Vërtetim i vazhdimit të shkollës për jetimët që kanë mbushur moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar.
  - Vendim i KMCAP-it për paaftësinë në punë të personave të familjes në ngarkim të të siguruarit të vdekur, kur ata janë në moshë pune.
  - Vërtetim i organeve të pushtetit lokal që në ngarkim të të vdekurit ishte një i/e ve, që mban një fëmijë deri në moshën 8 vjeç, i cili ishte në ngarkim të të vdekurit.
  - Vërtetim për personin e ve, që është kërkues për punë.
  - Procesverbal që provon faktin e vdekjes nga aksidenti në punë, si dhe vendimi i KMCAP, kur vdekja është shkaktuar nga sëmundje profesionale.
  - Vërtetim i organeve të pushtetit lokal që prindërit e prindërve nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë dhe jetonin në të njëjtën familje me atë që ka vdekur, jo më pak se një vit para vdekjes.
  - Vërtetim nga organet e prokurorisë ose gjykatës për rastet kur kërkohet të përfitohet nga dekreti nr. 758, datë 01.04.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut".
  - Vërtetim nga ministria përkatëse për humbjen e jetës së pilotit në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit.
  - Vërtetim që nuk është i punësuar apo vetëpunësuar, për jetimin që ka moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar, kur nuk vazhdon shkollën dhe është nën 18 vjeç (kur banon në qytet) dhe nën 16 vjeç (kur banon në fshat).
- Dokumentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara:**
- Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formularit-tip.
  - Vërtetim i pagës mesatare neto për vitin e fundit të punës.

## SHKRIMTARET MIRENJOHJE

Nga Zija Çela

# Zija Çela:

## Kurora ime e artë mbi varrin e Shuteriqit, është mirënjohja

(Shpesh u shkoj të vdekurve me lule. Ju lutem profesor, të më ndjeni, e mendova ndryshe kurorën Tuaj)

**T**ash të gjitha u thanë, e quajtën dhe kolosi i Letrave Shqipe. Në valën e parë të tronditjes, në afshin kur gjaku i kërcëllinte si vaj i djegur, dikush nuk ngurroi të përmendte edhe Çezarin. E Çezari jo, por padyshim që Kaligulë kurrë nuk ka qenë. Mirëpo tash, tash që vdiq, të gjitha u thanë dhe unë nuk vij ta lavdëroj Shuteriqin, por të lavdërohem prej zotërisë së tij, un grand monsieur.

Në gjithë katrahurën e mendimit të sotëm mediatik, me ndonjë përjashtim që meriton vëmendje, shkrimtarët e brezit tim (e filluam krijimtarinë aty nga vitet '70) kanë qëndruar gojëmbyllur, thua askush s'na paska pëlqyer para vitit 1990, se askënd nuk paskemi njohur, rrjedhimisht, jo që të na ketë mbajtur për dore si tutor nëpër rrugët e jetës dhe të krijimtarisë, por të na ketë ndihmuar të ecim vetë. Ndërkohë që çdo avion, dihet, me krahet e tij fluturon, por diku e ka një aerodrom prej ku është nisur. Natyrisht, historinë nuk e vulosin ata që flasin, ky është akt i historianëve, por dëshmitarët ndihmojnë për t'i dhënë objektivitet historisë dhe personazheve të saj, sidomos duke denoncuar çdo shtrëmbërim imazhi sa herë abuzohet me këmbimin e lenteve, domethënë, sa herë që e kaluara gjykohej spekulueshëm nga e sotmja.

Ndonëse narcizmit i kthej shpinën, me skrupujt ndër dhëmbë, po vihem gjaktohtë përballë një Pasqyre të madhe.

**2.** Nuk ishim takuar asnjëherë.



Në shkurt të vitit 1969, pasi kisha mbaruar studimet universitare dhe bëra shërbimin e shkurtuar ushtarak, u emërova në Helshan, një fshat që ndante Kukësin nga Tropoja dhe ku nuk kishte as dritë elektrike. Deri në verë, me dy kandila ndezë (kënga popullore vazhdon: të dy ishin fikë), kisha shkruar librin e parë, e kisha daktilografuar në Shkodër (dhjetë lekë faqja), e kisha çuar në shtëpinë botuese "Naim Frashëri", kisha bërë pushimet në Himarë dhe isha kthyer përsëri në Kukës. Kësaj here, nga Helshani më kishin transferuar në shkollën e mesme të Krumës, që atë vit hapje rishitas. Në Has vazhdoja të shkruaja, po mendja më rrinte te libri i parë, asnjë përgjigje. Kisha harruar që në sekretari pata lënë adresën e shtëpisë në Shkodër, rruga Reshit Rusi, nr. 40, dhe, në fakt, përgjigja pikërisht atje kish-



te vajtur. Duke e keqkuptuar, vëllezërit e mblodhën mendjen top, vendosën që ta fshihnin në arken e nënës pa më dërguar lajm, në mënyrë që të mos mërzhitesha, se "boll që isha larg". Për këtë shkak, nuk ma zunë me gojë as kur erdhi vera tjetër dhe, bashkë me time shoqe, u ktheva së-

risht për pushime. Por në pjacën e Shkodrës, teksa shëtisja nga Dugajët e Reja deri te Kafja e Madhe, dolën njerëz që sesi po më shihnin, me përshëndesnin ndryshe, me kut tjetër; dhe disa më uruan për tregimet. Kaq mjaftoi që të nesërmen të udhëtoja për Tiranë.

Çfarë kishte ndodhur? Redaktori i librit, Rinush Idrizi, në pritje që të bëhesha diku i gjallë pas përgjigjes, kishte botuar dy apo tre tregime në gazetën "Drita", të cilën atje ku jetoja nuk e shihja. Dhe kam një porosi, më thotë, kryetari i Lidhjes ka qejf të të njohë. Në zyrë nuk e gjetëm,




Dhimitër Shuteriqi

e gjetëm në kafe Tirana (atëherë në anë të bulevardit), sipër së cilës kishte edhe banesën. Më tha çfarë më tha, hoqi syzet, fërkoj sytë dhe, me ato tipare të gdhendura, të zmadhuara, të cilat i jepnin vetiu hiret e një sovranit të lindur, më zgjati letër që ta shkruaja aty kërkesën për anëtarësi në Lidhje dhe kërkesën për leje krijuese. Sugerimit të Rinushit se pas dy-tre muajsh do të dilte libri e mund të prisnim, iu gjeçj duke thënë se nuk është gjithmonë e nevojshme që, për të qenë anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve, të kesh domosdo edhe libra.

Mendimi i parë që më erdhi: O Zot, nuk paskam qenë i vetëm në vetminë dhe në mërzhinë time, ato dy kandidat

nuk qenkan fikë!

Pastaj vazhduan marrëdhëniet përsëri në distancë. (Unë hiç, naiv dhe i ndruajtur, asnjë letër a kartolinë falënderimi.) Një ditë, atje në Kukës më troket dera e shtëpisë dhe, sapo e hap, shoh dy miq: Faik Ballancën e Moikom Zeqon, të cilët aso kohe punonin në shtypin letrar të Lidhjes. Përshëndoshemi edhe më thonë: Kemi një porosi për ty: jemi nisur për reportazh në Fierzë, por Kryetari na porositi të vijmë deri në Kukës dhe të sjellim këtë makinë. Ishte një makinë shkrimi e vogël, Olivetti me valixhe, fringo e re, një alet që në atë kohë, për ëndrën e një shkrimtari të ri shqiptar, një shkrimtari dyfish të izoluar, t'i hidhte trutë



në erë. Më vonë mora vesh se, gjithë-gjithë, dhjetë makina të tilla kishte shpërndarë Lidhja, por Shuteriqi ishte kujtu-

ar që njëra të arrinte tek më i riu.

Pastaj, si më parë, marrëdhëniet vazhduan gjithnjë

në distancë (dhe prapë unë, zavalli, prej një zori ta pash-pjegueshëm, asnjë letër e kartolinë-falënderimi). Natyrisht, lejet krijuese kishin filluar, nisën me tre e shpejt u bënë nëntë muajshe.


Kishte "vinça" atëherë, vinça nepotizmi që e merrnin njeriun dhe e çonin ku të donin dhe e ngrinin sa të donin, njëlloj si sot, madje sot "vinçat" janë shtuar; në daç për pushtet, në daç për nënpunësi, në daç për bujë e lardi mediatike. Unë vinça nuk kisha, vazhdoja të mbetesh në Kukës, por aq pishman nuk kam qenë. Sidoqoftë, nuk mund të them se nuk e ndieja vetminë. Dhe, në atë farë angështie që nganjëherë më kapte deri në sflitje, më vjen një ditë një telegram për të marrë pjesë si fitues (e mbajmend) në ceremoninë e ndarjes së çmimeve: kishte pasur një konkurs letrar (30-vjetori i Çlirimit) dhe kisha një libër me tregime e novela. Shpallja u bë në Institutin e Lartë të Arteve. Lexohen fituesit, unë kërkund. Duket se çmimi ishte hequr natën ose në castet e fundit për shkak të novelës "Drita që pikon në pyll", një histori më vete kjo. Jo, do të duhen të paktën dy treshita: revista "Nëntori"

nuk kishte pranuar ta botonte dhe, kur novela doli brenda librit, po në faqet e revistës u cilësua me "gabime ideore". Cilësime të tilla nuk ishin shaka, por damkë që mund të të penalizonte, siç u penalizuan disa.

Sesi u mblodhëm pas ndarjes së çmimeve në Bar-Sahati një grup shkrimtarësh, ndër të tjerë Koreshi, Kondo e më duket edhe Koço Kosta, të cilit gjithashtu i kishin rënë vizë në listën e fituesve. Në tavolinë thotë Teodor Laço: "Profesor, thuajti ndonjë fjalë Zijait, është i mërzitur se ia hoqën çmimin dhe kushedi ç'do të mendojnë në Kukës!" Profesor Dhimitri foli pa e ngritur kokën: "Nuk ka nevojë për fjalë, Laço. Ta lexova librin në plazh, - m'u kthye, - dhe më pëlqeu shumë."

O Zot, thashë prapë me vete, nuk paskam qenë i vetmuar në vetminë time dhe në sflitjen time! Ato dy kandidata ndezë sikur m'u bënë katër.

Nuk vonoi dhe një të diel, një miku im kukësi që i merrte gazetata drejt e në zyrat e postës, sepse nuk duronte sa t'ia sillnin në shtëpi, më vjen me një "Drita" në dorë e më thotë: Kam një sihariq për ty. Dhe e di nga? Nga Shuteriqi. Kishte botuar një artikull të gjatë për librin dhe dua të them... dua të them se me lavdërimet gjithnjë ashtu më ndodh, i lë të bëjnë rikoshet, por çdo lavdëratë e tij më turbullonte. Dhe turbullancat, më vonë, bëhen gjendje për krijimtari. Pra, mjeshtri kishte filluar të më lexonte qëkur isha njëzet e tre vjeç (e kush i ndiqte me aq vëmendje, sa Shuteriqi, shkrimtarët e rinj) dhe, kur isha njëzet e tetë, në shkrim shkante të më quante... Stop këtu, por ja çfarë më ka pëlqyer veçmas në atë shkrim: as që merreshin parasysh raportet e ngurta qendër - periferi, aurreora e personalitetit të tij, ndryshimi i dukshëm i mënyrës së të shkruarit dhe ndryshimi i ndjeshëm i moshës midis nesh, përkundrazi, ngazëlente singëriteti i tij emancipues dhe një entuziazëm i hapët që rrallë, rrallë e për mall e gjen tek akademikët. Dhe më duhet të kujtoj se kishte marrë sipër një libër "allasoj, me hije nga juria e nga shtypi", dhe më duhet doemos të kujtoj se nuk kishte shumë që, për liberalizëm, e kishin shkarkuar edhe si kryetar i Lidhjes.



takonin ceremonialet. Dhe e kisha provuar edhe ndryshe, sepse... Sepse ndodhte që ndokush të hynte në zyrë, të më shihte ku isha ulur dhe, për shkak të moshës a ku di pse, prapëseprapë pyeste: "Dësh kryeredaktorin, ju lutem, ku është kryeredaktori?"

Dritëroi si Dritëroi, nuk pranoi mëdyshje, por sigurisht që e dinte stimën time për Dhimitër S. Shuteriqin. Aq më tepër që, ndërkohë, tashmë isha takuar disa herë me Profesorin. Kujtoj si shkoja në shtëpinë e tij për t'i marrë ndonjë tregim për revistën apo gazetën. Dhe vonohesha aty. Ulur në kolltuk, me pamjen e tij impozante, por me sytë gjithnjë të lagur si ta ndiqte një përmallim i largët dhe i përjetshëm historik, më lexonte dy, tre apo edhe katër tregime, seancë pa seance, tregime shkruar figurave të Rilindjes apo bëmëtarëve nga mote më të hershme. Por fjalën e kisha të fjalimi.

Dhe e mbajta në selinë e Lidhjes, në sallën e zbkuruar për mbrëmjen jubilarë, mbushur plot me emra në zë, në prani dhe të Foto Çamit, që atëherë besoj se kishte detyrën e sekretarit të KQ të partisë. Në mos gaboj, e fillova:

"Sa herë që shoqëria ka nevojë të hedhë një hap më tej, në një fushë të caktuar apo në fusha të ndryshme të jetës, ajo bëhet më e vëmendshme ndaj përvojës së pasur të saj. Atëherë bëhen më tërheqës edhe shembujt që janë vlerësuar e meritohjnë vërtet të vlerësohen, sepse duke u ndjekur nga të tjerë, çlirohen energji të reja. Në fushën e artit, të shkencës dhe kulturës, Shuteriqi është një shembull që flet. Në Bota e Re, qershori 1936, ju profesor jeni shprehur: 'Në daçim të punojmë me tërë vullnetin tonë për kombin, puna jonë e zjarrtë do të na mbajë të rinj edhe në pleqëri.' Pleqëria tani ju ka ardhur, urdhëri i

moshës s'na lejon të flasim ndryshe. Por, në thell, në përvjetorin tuaj është prapëseprapë rinia ajo që na mblodhi, rinia e mendimit dhe e fjalës së bukur që buron nga vepra juaj e gjatë letrare e shkencore.

Tani, pas tetëmbëdhjetë vjetësh, mbërrin lamji i vdekjes. Natyrisht që nuk pata rastin të mbaja fjalim ndanë varrit, por mendimi m'u kthye shpejt te modeli që shfaqin personalitetet. E po ta mbaja fjalimin, do të isha tepër lakonik, do të përmendja pa jetën modelin e tij, do ta thoja troç dhe në invers, duke huazuar, atë kumtimin e njohur se nuk vij ta varros, por ta lavdëroj Shuteriqin, dhe do ta mbyllja kështu: Në jetë të jetëve qoftë e bekuar mirënjohja, amen!


3. Por do të mbeteshin shumë pengje. Për shembull: Shuteriqi bëri për kulturën shqiptare, mirëpo sa bëme ne për Shuteriqin? I dhama ofiqe, tituj, medalje, pastaj e përlyem, e çapërlyem në media edhe pas dy goditjeve në zemër, e lamë vetëm në pleqërinë e thellë, pa u gjetur qeveri dhe pa u gjetur njeri që të nxirrte dy kacidhe nga xhepi për t'ia botuar librat në dorëshkrim, librat që i kishte të gatshëm dhe për të cilët bënte thirrje publike se do t'ia kishte fort ënda t'i shihte të botuar në të gjallë të tij.

Nëse ka breza që gabuan duke iu përkushtuar një ideali të rrejshëm, ne po gabojmë duke u zhveshur nga çdo idealizëm dhe duke iu nënshtruar një materializmi vulgar. Në jetë të jetëve qoftë e mallkuar vberëria e mizorisë dhe mëkati i hipokrizisë. Amen!

(Ky shkrim është përgatitur nga shkrimtari Zija Çela në korrik të vitit 2003 me rastin e ndarjes nga jeta të shkrimtarit dhe akademikut të njohur Dhimitër S. Shuteriqi dhe botohet me lejen e dëshirën e autorit)



United Nations Development Programme



**TENDER ANNOUNCEMENT**

**Subject: – the "RFP ASSESSMENT OF CURRENT MUNICIPAL PERFORMANCE MEASUREMENT SYSTEMS AND IDENTIFICATION OF POTENTIAL COMPLEMENTARITIES" for STAR 2 Project**

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP 52734**

**RFP for "RFP ASSESSMENT OF CURRENT MUNICIPAL PERFORMANCE MEASUREMENT SYSTEMS AND IDENTIFICATION OF POTENTIAL COMPLEMENTARITIES" for STAR 2 Project**

For more details please refer to the link below:  
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/>

**Relevant dates:** All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 08-Feb-19

**Address for communications:**  
 Email: [procurement.al@undp.org](mailto:procurement.al@undp.org)  
 Or  
 Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor  
 Tirana, Albania

Thaçi: Marrëveshja me Serbinë ka të bëjë me korrigjimin e kufijve.

Presidenti kosovar: Do sigurojmë stabilitet në rajon si dhe mundësinë e anëtarësimin në BE

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka pranuar se marrëveshja finale me Serbinë nënkupton edhe 'korrigjimin' e kufijve. "Kjo marrëveshje nuk ka të bëjë vetëm me korrigjimin e kufijve, por edhe me aspekte të tjera", ka shkruar ai në një postim në Facebook pjesë të përgjigjeve të tij dhënë për agjencinë e lajmeve të Austrisë (APA). Thaçi ka shkruar se marrëveshja do të krijojë më shumë stabilitet dhe paqe në rajon, mundëson anëtarësimin e të dyja vendeve në BE, nënkupton që nuk do të ketë më kufij monoetnik e që trajton edhe çështjen e personave të zhdukur.

**POSTIMI I PLOTË:** Në një intervistë për Agjencinë e Lajmeve të Austrisë "APA", kam biseduar për zhvillimet politike në Kosovë dhe rajon. Duke folur për fazën e fundi të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, kam theksuar se një marrëveshje mes nesh do të krijojë më shumë stabilitet dhe paqe në rajon. Për Kosovën dhe Serbinë kjo do të mundësojë anëtarësimin në BE, derisa për Kosovën edhe në NATO. Nuk do të ketë kufij

monoetnik dhe të dyja shtetet do të jenë shumënike. Arritja e një marrëveshjeje ligjërisht obliguese, nënkupton që nuk do të ketë më kurrë luftë ndërmjet dy shteteve. Qytetarët do të kenë një jetë më të mirë, sepse nga jetësimi i marrëveshjes do të përmirësohet edhe gjendja ekonomike dhe do të krijojmë më shumë vende të punës, derisa kufijtë do të largohen, duke u bazuar në modelin evropian. Shansi për të arritur një marrëveshje të tillë asnjëherë nuk ka qenë më i mirë, sepse kemi mbësh-

tetjen e BE-së dhe SHBA-së. Rusia është që edhe Rusia do të jetë në gjendje të pranojë marrëveshjen, nëse të dyja palët pajtohen. Prandaj, është më rëndësi që të shfrytëzohet ky momentum për të arritur një marrëveshje të balancuar, e cila merr parasysh interesat e dy vendeve. Në të kaluarën nuk ka pasur një gatishmëri të tillë. Nëse ne nuk e shfrytëzojmë këtë shans, atëherë qytetarët tanë do të na mallkojnë në dekadat e ardhshme. Kjo marrëveshje nuk ka të bëjë vetëm me korrigjimin



e kufijve, por edhe me aspekte të tjera. Kjo marrëveshje do të jetë gjithëpërfshirëse, e cila trajton edhe çështjen e tjera, si çështjen e personave të zhdukur nga lufta e fundit, të cilët edhe më tutje nuk janë kthyer në vendlindje. Marrëveshja ka për qëllim të zgjidhë përfundimisht problemet dhe të mos jetë një zgjidhje e përkohshme,

të cilës pastaj duhet t'i rikthehemi. Nuk do të ketë as "Shqipëri të madhe", as "Kosovë të madhe". Në vend të kësaj, ne synojmë integrimin e rajonit në Evropën e bashkuar. Në këtë intervistë kam folur edhe për ushtrinë e Kosovës. Ky ishte një vendim i duhur i një shteti sovran, i bazuar në vullnetin e popullit të Kosovës.

"Rrethohet" parlamenti grek, forcat blu përplasen me protestuesit në sheshin "Sintagma"

# Marrëveshja e Prespës, Athina 'zien në flakë'

## Policia, gaz lotsjellës ndaj 150 mijë qytetarëve

Ditën e djeshme shumë qytetarë grekë u mbledhën para parlamentit për të kundërshtuar Marrëveshjen e Prespës me Maqedoninë. Media radio "SKAI" shkruan se të paktën 600 mijë persona pritshin të dilnin në shesh deri në orët e vona të së dielës. Tubimi zhvillohet përpara një votimi të parashikuar mbi marrëveshjen e emrit të Prespës në parlament javën e ardhshme, të cilin qeveria pret të sigurojë të paktën 151 vota pro. Grupet e qytetarëve kanë intensifikuar një fushatë në mediat sociale për të tërhequr sa më shumë protestues në sheshin "Sintagma" për një protestë kundër "Marrëveshjes së Prespës" midis Greqisë dhe Maqedonisë. Policia në Athinë u shpreh se në tubim do të janë përafërsisht 140,000 mijë qytetarë, por sipas mediave greke, organizatorët e saj kanë hedhur poshtë këto shifra duke theksuar se do të jenë dhjetë herë më shumë. Dhjetëra autobusë janë marrë me qira nga autoritetet lokale, por bashkë me ta kishat dhe manastiret kanë ndihmuar në transportin e njerëzve nga qytetet e tjera drejt sheshit "Sintagma" në Athinë. Policia ka rrethuar parlamentin e Greqisë, ndërsa janë shënuar përplasjet e para mes efektivëve dhe protestuesve. Këta të fundit edhe pse të vogël në numër, kanë tentuar të hyjnë në pjesë e sipërme të sheshit në drejtim të parlamentit, por kjo gjë është ndaluar dhe penguar nga policia. Ndërkaq është shoqëruar



me tensione dhe përplasje protesta e një pjesë të qytetarëve grekë para parlamentit në Athinë të cilët kundërshtojnë marrëveshjen e Prespës me Maqedoninë për çështjen e emrit. Rreth 60 mijë protestues me flamuj kombëtarë në duar kanë vërshuar para parlamentit, ndërsa raportohet se ka pasur edhe persona të lënduar. Mësohet se një 45-vjeçar është plagosur me thikë, ndërsa dhjetëra të tjerë janë lënduar pasi kanë shkelur njëri tjetrin duke u përpjekur për të dalë nga tuma. Policia ka përdorur gaz lotsjellës dhe tymuessa për të shpërndarë protestuesit. Tubimi zhvillohet përpara një votimi të parashikuar mbi marrëveshjen e emrit të Prespës në parlament javën e ardhshme, të cilin qeveria pret të sigurojë të paktën 151 vota pro. Grupet

e qytetarëve kanë intensifikuar një fushatë në mediat sociale për të tërhequr sa më shumë protestues në sheshin "Sintagma" për një protestë kundër "Marrëveshjes së Prespës" midis Greqisë dhe Maqedonisë. Me thirrje kryesisht nga "komiteti i luftës për grekëzimin e Maqedonisë", qindra autobusë meqë vijnë nga gjithë vendi dhe në veçanti nga veriu i Greqisë, mbërritën sot në Athinë duke transportuar mijëra manifestues, sipas organizatorëve, për të marrë pjesë në këtë protestë. Marrëveshja mbi emrin e ri të Maqedonisë, e nënshkruar mes Athinës dhe Shkupit qershorin e kaluar, synon t'i japë fund konfliktit gati 30-vjeçar mes dy vendeve fqinje duke e riemëruar këtë vend të vogël të Ballkanit "Republika e Maqedonisë së Veriut".

**PROTESTA**

Grupet e qytetarëve kanë intensifikuar një fushatë në mediat sociale për të tërhequr sa më shumë protestues në sheshin "Sintagma" për një protestë kundër "Marrëveshjes së Prespës" midis Greqisë dhe Maqedonisë. Policia në Athinë u shpreh se në tubim janë përafërsisht 140,000 mijë qytetarë.



**Shpërthen Vulin: Shqipëria e Madhe' po krijohet para syve tanë**

Aleksandar Vulin ka thënë se çfarëdo që përkon me Serbinë lidhur me marrëveshjen me Kosovën do të përkrahet nga Rusia. Ministri serb i Mbrojtjes ka theksuar se Rezoluta 1244 është ende në fuqi dhe nëse dikush mendon se pak të rezolutës mund të gjendet zgjidhje e ka gabim. "Është shumë e vështirë të shpjegohet rruga evropiane për shkak të politikës me standarde të dyfishta të Prishtinës. Ata vendosën tarifa ndaj produkteve të Serbisë për të cilat Evropa nuk po bën sa duhet presion", ka thënë ai. Sipas ministrit serb Evropa po hesht përderisa "një Shqipëri e Madhe po krijohet para syve tanë". Asnjë fjalë e vetme për këtë. Mund ta imagjinoni se çfarë do të ndodhte nëse dikush në Serbi do përmendte diçka të tillë. Një Shqipëri e Madhe është shumë e rrezikshme për Ballkanin", është shprehur Vulin. Ai ka shtuar se serbët nuk duhet të pranojnë të bëhen pjesë e Ushtrisë së Kosovës pasi me një gjë të tillë dëshmojnë se janë kundër vëllezërve serb.

## VMRO-DPMNE: Zaev, njeriu që hoqi dorë nga emri shekullor

Nëpërmjet një deklarate të lëshuar nga partia opozitare maqedonase VMRO-DPMNE thuhet se Zoran Zaev është person anti-maqedonas dhe do të mbahet mend si njeriu që hoqi dorë nga emri shekullor i shtetit. "I njëjti Zaev në kundërshtim me vullnetin e qytetarëve, me kërcënimin e shty ndryshimet kushtetuese dhe ndryshoi emrin kushtetues të shtetit. Jo vetëm që e ndryshoi emrin, ndryshoi edhe identitetin, gjuhën dhe historinë e shtetit dhe popullit maqedonas. Me fjalë tjera hoqi dorë nga gjithçka që është maqedonase", thuhet në deklaratën e VMRO-DPMNE-së. Opozita shton se edhe pse në fushatë ai betohet se nuk do të bënte në veprim të tillë kapitullues, kur e mori qeverisjen për shpëtim të karrierës politike ai i shiti interesat shtetërore dhe kombëtare. Nga VMRO-DPMNE thonë se në zgjedhjet e ardhshme kundërdarë qytetarët do të vendosin nëse janë "pro" emrit "Maqedoni e Veriut" apo kundër.





## MJEKU POPULLOR




Ylli Merja:  
Si të trajtoni  
ulcerën me  
gjethet e mëllagës,  
receta e çajit

## Albana Duni:

◆ Mjekja  
gastrohepatologe:  
Dieta e varfër  
me fibra,  
pasojat e saj  
në organizëm



## LLOJET E PADESHIRUESHME



Urdhri i  
Farmacistëve: Llojet  
e antibiotikëve që  
duhet të kufizohen

## Hemorragjitë në traktin e sipërm, si duhen mjekuar

"Trajtim i menjëhershëm, mund të sjellë vdekjen e pacientit"

• Kërpudhat, ilaç kundër depresionit. Efektet e mrekullueshme të vajit të lirit në organizëm

Mjekja gastrohepatologe: Dieta e varfër me fibra, pasojat e saj në organizëm

# Albana Duni:

## Hemorragjitë në traktin e sipërm, si duhen mjekuar

"Trajtim i menjëhershëm, mund të sjellë vdekjen e pacientit"

Volta Duro

Me kalimin e moshës, kequshqyerjen dhe shfaqjen e sëmundjeve në traktin gastrointestinal, mund të prekemi edhe nga hemorragjia digjестive. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në Gazeta Shqiptare, mjekja gastrohepatologe, Albana Duni tregon të gjithë faktorët që ndikojnë në shfaqjen e hemorragjive, lokalizimet e ndryshme që kanë si dhe format e trajtimit. Më tej ajo thekson se femrat janë më të predispozuar se meshkujt për tu prekur nga këto hemorragji. Gjithashtu, mjekja ndalet edhe te divertikulat (xhepa të vegjël që formohen në murin e mukozës së brendshme të zorrës. Shpesh gjenden në zorrën e trashë, por, gjithashtu, mund të zhvillohen dhe në pjesët e tjera të traktit tretës prej ezofagut deri në zorrë të trashë. Prezenca e shumë divertikulave në numër qehet divertikulozë. Shkaku kryesor i zhvillimit të tyre është dieta e varfër në fibra. Kur këta xhepa të vegjël inflamohen krijojnë një situatë të quajtur divertikulitis. Sëmundja divertikulare është shumë e shpeshtë në Amerikë ose në shtetet e industrializuara dhe në më shumë se 50% të rasteve prek

moshën mbi 60-vjeç. **Po diverticulosis kur shfaqet dhe si bëhet diagnostikimi i saj?**

Prezenca e shumë divertikulave të pa inflamuara quhet diverticulosis. Në përgjithësi njerëzit me diverticulosis nuk kanë shenja dhe janë të informuar që i kanë ato. Diagnostikimi bëhet me anë të grafive dhe sigmoidoskopive rutinë.

**Cfarë rekomandoni ju si gastrohepatologe në këto raste?**


Menaxhimi i diverticulosis është parandalimi i konstipacionit. Rekomandohet një dietë e pasur me fibra krunde dhe psilium që mund të përshkruhen nga mjekët. Ky lloj trajtimi ka për qëllim zbutjen e materialeve fekale duke ulur presionin e tyre mbi zorrën. Rekomandohet që gjatë ditës të merren rreth 10 gota ujë të cilat ndihmojnë në një jashtëqitje të lehtë pa shterzime. Ujja në mënyrë të rregullt në tualet për të defekuar është një mënyrë parandalimi të konstipacionit.

Rekomandohet të shmangët konsumimi i lajthisë dhe farave (mbetet e diskutueshme sepse ato

nuk treten plotësisht dhe mund të mbesin nëpër divertikula dhe të shkaktojnë inflamacion).

**Cfarë ndodh në organizëm kur ushqimi nuk arrin të tretet plotësisht?**

Diverticulitis ndodh kur divertikulat inflamohen ose infektohen. Shkaku mendohet të jenë ushqimet e patretura, mbetjet fekale dhe bakteret duke shkaktuar inflamacion. Simptomat e shpeshta të divertikulitis janë: Dhimbje/discomfort në pjesën e poshtme të barkut; Ndryshime në jashtëqitje diarre/konstipacion; Fryrje dhe distendim i barkut; Dhimbje në kuandartin e poshtëm majtas të barkut. Ndërkohë të moshuarit mund të mos kenë temperaturë ose dhimbje abdominale të cilat komplikojnë diagnozën. Divertikulitis mund të çojë në hemorragji si shkak i perforacionit të ndonjë prej tyre. Trajtimi përfshin antibiotikët për të luftuar infeksionin dhe menaxhimin e dhimbjeve me ciprofloxacilin 500mg 2 here në ditë ose cefalosporinë të gjeneratës së tretë, e kombinuar me metronidazol 500mg 3 herë në ditë për 10-14



Mjekja gastrohepatologe Albana Duni

ditë.

**Kur mund të jetë e nevojshme ndërhyrja kirurgjikale?**

Nëse nuk përmirësohen simptomat atëherë duhet të dërgohet në qendër spitalore për tu bërë drenazh perkutan nën drejtimin e ekos transabdominale ose te CT scannerit. Kirurgjia mund jetë e nevojshme në ato raste kur kemi obstrukcion ose perforacion.

**Në cilat raste pacienti shfaq hemorragji digjестive dhe ku lokalizohet ajo?**

Të moshuarit janë më të rrezikuar për të pasur hemorragji dhe sigurisht kërkojnë ndërhyrje të shpejtë mjekësore. Prezantimi i hemorragjisë varet nga lokalizimi i lezionit hemorragjik (hematemezë, melena, rektoragji). Hematemezis shfaqen me të vjella hemorragjike në formën e një gjaku të freskët (hemorragjinë aktive), në formën e gjakut si "lulum kafeje" dhe gjaku me koagula (hemorragji e ngadalshme). Ndërkohë melena është një lloj hemorragjie nga lezionet e traktit të sipërm dhe shfaqet kur sasia e gjakut kalon më shumë se 50ml dhe ka ngjyrë të zezë. Ndërkohë rektoragjia është një lloj tjetër hemorragjie që vjen nga lezionet e poshtme të traktit tretës që mund të jetë gjak i kuq i freskët, me koagula, i përzier me materie fekale dhe diarre sanguinolente. Në 75% të hemorragjive të traktit të sipërm: 50% e hemorragjive vijnë gjatë përdorimit të aspirinës; 50% e tyre vijnë gjatë ulcerave ose erozioneve, divertikulave ose xhepave në zorrë dhe e tumoreve të traktit tretës. Femrat janë në një risk më të lartë se meshkujt për tu prekur nga këto hemorragji.

**Si realizohet trajtimi i hemorragjisë digjестive?**

Hemorragjia digjестive kërkon ndihmën mjekësore spitalore dhe

diagnostikim të shpejtë sepse mund të jetë kërcënuese për jetën e pacientit. Përveç vlerësimit të gjendjes së pacientit nëpërmjet monitorimit të shenjave vitale, kërkohet kuadri i gjakut dhe ekzaminimet që mund të nevojiten ku dihet që për traktin digjестiv ajo që vë diagnozën është endoskopia e sipërme ose e poshtme, pra gastroskopia dhe kolonoskopia. Këto ekzaminime jo vetëm përcaktojnë burimin e hemorragjisë, por edhe bëjnë të mundur të aplikohet terapi hemostatike pra të ndalojë hemorragjinë me metoda të thjeshta endoskopike.


**Cfarë i shkakton gazrat?**

Teprica e gazrave në stomak zakonisht është e lidhur me dietën. Disa ushqime që shkaktojnë gazra janë: pijet me gaz, disa lloje frutash, fasulet dhe perimet, akulloret dhe vezët që përmbajnë sulfur. Tjetër arsye e pranishme është gazrave është dhe intolerance prej laktozës.

Është normale që njeriu të nxjerrë gazra 7-20 herë/ditë. Të kesh gazra nuk do të thotë që je i sëmurë.

**Cilat janë simptomat e tyre?**

Gazrat mund të shkaktojnë dhimbje abdominale, fryrje barku dhe ndjenjë jo rehatie. Simptomat zakonisht janë përmirësuar me shmangien e ushqimeve gazproduese, duke ecur ose duke ndryshuar pozicion. Patjetër që një vlerësim i plotë është i nevojshëm tek të moshuarit i cili konsiston në vlerësimin e ndryshimeve funksionale të zorrës, dhimbjes shoqëruar me simptoma gastro-intestinale. Gromësimat e shpeshta zakonisht janë si rezultat i gëllitjes së tepërt të ajrit, megjithatë duke marrë parasysh se tek të moshuarit kjo mund të jetë një simptomë për një problem tjetër serioz është shumë e rëndësishme vlerësimi për gastritet dhe ulcerat peptike.



Voltiza Duro

Sëmudjet më të përhapura të stomakut për momentin janë gastriti dhe ulcera. Shumë njerëz preferojnë të pinë kafe esëll ose të dalin nga shtëpia pa konsumuar mëngjes. Për shumë individë, të konsumosh një mëngjes shumë të madh është e vështirë, dhe e pamundur, por mund të hani një banane, apo një mollë me e pakta. Idealja do të ishte të konsumoni një mëngjes me fibra si tërshërë me kos, dhe fruta të thata. Fibrat në mëngjes thithin të gjitha lëngjet në stomak që janë grumbulluar gjatë natës, dhe i nxjerrin të gjitha toksinat jashtë organizmit. Gjithashtu, ato ndihmojnë në një zorrë të shëndetshme, pasi e pastrojnë komplet nga mbetjet që mund të grumbullohen aty.

#### Vështirësia në tretje

Shpeshherë na ndodh që barku të rrijë i fortë, i fryrë, të kemi gurgullimë gazrash, vështirësi në tretje, etj. Në këtë rast kemi të bëjmë me dispepsi ose vështirësi në tretje të ushqimit. Shkaqet e këtij çrregullimi funksional mund të jenë të ndryshme: shkaqe stresuese, psikologjike, dietat ushqimore, ndryshimet fiziologjike të mëlçisë, mbingopja etj. Nëse kjo dispepsi zgjat më tepër se 1 deri 2 ditë, duhet vepruar për të ndërhyrë sa më parë për normalizimin e tretjes. Korrigjimi i këtij problemi funksional do të lidhet me faktin se sa ne do të analizojmë: Çfarë kemi ngrenë?; Çfarë kemi pirë?; Sa e kemi lehtësuar tretjen me regjimin e të ushqyerit dhe dietën ditore?;

#### Si mund ta rregullojmë mostretjen e ushqimit?

##### Trajtimi

Për ta kthyer në normalitet tretjen duhet të korrigojmë dietën ushqimore dhe për ta shpejtuar normalitetin duhet të përdorim disa nxitës për tretjen. Tek fëmijët e moshave 0 deri 1 vjeç shumë sukses mund të përdorni çajin e mendrës së butë dhe kamomilit. Fëmija 0-1 vjeç mund të pijë gjatë ditës disa herë nga 1-2 lugë supe, ndërsa fëmijët 1-5 vjeç pinë 2-3 filxhanë çaji në ditë. Duke përvëlur në 1 gotë ujë 1 lugë gjelle mendër dhe gjysmë luge kamomil, ne lehtësojmë tretjen dhe luftojmë ngërçin e barkut të fëmijëve. Ky çaj ka veprim qetësues në qelizat e muskujve të stomakut, kurse tek të rriturit, krahas dietave, japin rezultate pozitive edhe çajrat aromatikë me veprim kalminativ, anti-inflamator. Pra, përgatitja e një çaji bimor me rigon, mendër, borzilok, kamomil, geutian ose valerianë, normalizon shumë shpejt tretjen dhe jashtëqitjen. Çaji më i mirë është ai që përgatitet nga përzierja bimore si më poshtë: Në 2 gota ujë ziejmë për një minutë 1



Mjeku popullor: Kujdes, rastet kur duhet të korrigojmë dietën ushqimore

## Ylli Merja: Si të trajtoni ulcerën me gjethet e mëllagës, receta e çajit

"Çfarë duhet të konsumoni për një stomak të shëndetshëm"



lugë gjelle mendër, gjysmë lugë gjelle rigon; gjysmë lugë gjelle kamomil; si dhe gjysmë luge gjelle borzilok. Çaji kullohet pas 10 minutash e nga ky çaj fëmija mund të pijë 1-2 filxhanë kafe në ditë, ndërsa të rriturit 2 filxhanë çaji në ditë.

#### Ulcera

Kur në stomak nuk kemi të bëjmë vetëm me një mostretje, por edhe me një prishje të pH-it (stomaku është acid dhe ju ndjeni djegie të shpeshta, që mund të vijë nga përdorimi i tepruar i alkoolit, duhanit, ilaçeve, rritjes së inflamacionit bakterial nga *Helicobacter pylori*), atëherë në stomak nuk vepron negativisht vetëm

#### BIMËT QË KËSHILLOHEN PËR PROBLEMET E STOMAKUT:

- Turmerici ka veti antiinflamatore të fuqishme
- Gjembgomari rregullon sasinë e enzimave që prodhohen nga tëmthi e mëlçia, dhe kështu rregullon tretjen e ushqimit
- Shelgu përmban mucilagje, që vesh ezofagun e stomakut dhe nuk lejon gërryerjen e tyre nga aciditeti apo bakterit.
- Ananasi përmban enzima tretëse, që largojnë djegien e zemrës dhe fryrjen e zorrëve, ka veti antiinflamatore.

një element keqbërës, por njëherësh disa. Atëherë edhe efektet negative në muret e stomakut do të jenë më të mëdha. Në këto raste skuqja e mureve të sto-

makut nga brenda, gërryerja e tyre shoqërohet shpesh me dhimbje të forta 1 ose 2 orë pas buke, me gromësima që nxjerrin një gaz të thartë në grykë, një avull që shpesh

shkakton kollë, ngjirje zëri etj. Në këtë rast kemi të bëjmë me një ulcerë në stomak. Ulcera formohet kur kemi një dëmtim të mukozës së brendshme të stomakut. Në rastet e ulcerave, dhimbjet janë shpuese dhe djegin, madje edhe zgjatin. Shumica e ulcerave shkaktohen nga infeksionet bakteriale dhe bakterit që shkakton ulcerë quhet *Helicobacter pylori*. Ulcerat e tjera mund të shkaktohen nga përdorimi i aspirinës ose i barnave të tjera. Nëse lihen pa u mjekuar ulcerat bëhen problem shqetësues për shëndetin ose de-generojnë në sëmundje të rënda.

#### Kurimi i ulcerës

Përdorimi i çajit me gjethet e mëllagës (*Malva silvestris*) minimizon shumë efektin ulceroz. Përdorimi i 2-3 gotave çaj të përtuar nga zierja për 1-2 minuta e 3 gotave të çajit me 3 lugë gjelle mëllagë jep rezultate të mira në efektin mbrojtës të sistemit të tretjes, mushkëri etj. Përdorimi i gjetes së arrës dhe petave të brendshme në frutin e arrës bëjnë që të "arohen" me shumë sukses kruajtjet e brendshme të mureve të stomakut. Ndërsa përdorimi i një të bardhe veze në mëngjes esëll me qumësht bën që të amortizohen plotësisht përplasjet e ushqimit me muret e stomakut, pra afrojnë efektin gërryerës të ushqimit brenda mureve të stomakut. Për të patur të sigurt shërimin e ulcerës është mirë të përdorim një kurë komplekse me vajra bimorë dhe esenciale, propolis blete dhe një mikser çajrash.

# Urdhri i Farmacistëve: Llojet e antibiotikëve që duhet të kufizohen

**E**MA ka rivlerësuar efektet e padëshiruara lidhur me përdorimin e antibiotikëve të klasës së Kinoloneve dhe Flourkinoloneve të administruara në rrugë orale, intravenoze ose inhalatore. "Efektet e padëshiruara të shfaqura në mënyrë të përsëritur, kanë sjellë pezullimin ose kufizimin e përdorimit të antibiotikëve të klasave Kinolone dhe Flourkinolone. Komiteti i Barnave për Përdorim të Vlerësimit Human të EMA (CHMP) ka konfirmuar rekomandimin e Komitetit të Vlerësimit të Riskut për Farmakovigjilencë (PRAC) dhe ka arritur në përfundimin që autorizimi për tregtim i barnave që përmbajnë cinoksacina, flumekina, acid nalidiksik e acid pipemidik duhen pezulluar", thekson Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë.

## Efektet e padëshiruara

-Barnat që i përkasin klasës së flourkinoloneve (ciprofloksacinë, levofloksacinë, moxifloksacinë, norfloksacinë, pefloksacinë, prulifloksacinë dhe rufloksacinë) mund të shkaktojnë efekte të padëshiruara nga përdorimi i përsëritur ose për një kohë të gjatë duke prekur tendinat, muskujt, artikulationet, sistemi nervor.

-Këto efekte të padëshiruara përfshijnë: tendina të inflamuar, tendina të dobëta, dhimbje ose dëmtime muskulare, fryrje, ënjtje të artikulationeve, vështirësi në ecje, ndjesia e gjilpërave në këmbë (ndjesi shpuese), djegie, lodhje, depresion, probleme të memories, gjumit, shikimit, veshit, ndryshimi i shijes dhe nuhatjes.

-Enjtja e lezioneve të tendinave mund të verifikohet brenda dy ditëve të para të fillimit të trajtimit me një flourkinolon, por mund të verifikohet dhe disa muaj pas ndërprerjes së trajtimit.

-Duhet të ndërprisni marrjen e barit të klasës flourkinolon dhe të merrni kontakt të menjëhershëm me mjekun në rastet e mëposhtme:

-Shfaqje të lezioneve të tendinave si dhimbje ose ënjtje (duhet të mbani regjim shtrirë);

-Dhimbje, ndjesi të shpimit si të gjilpërave në këmbë, gudulisje, mpirje, djegie ose dobësim në mënyrë të veçantë të këmbëve dhe krahëve.

-Ënjtje të shpatullës,



krahut, këmbëve ose vështirësi në ecje, lodhje, depresion, probleme me memorien, shqetësime të gjumit, shikimit, ndryshimit të shijes dhe nuhatjes. Mjeku vendos nëse pacienti duhet të vazhdojë trajtimin ose nëse është e nevojshme të merret një antibiotik tjetër.

-Shfaqja e dhimbjes së artikulationeve, enjtja, dëmtimi i tendinave është më i shprehur në pacientët mbi 60 vjeç, me probleme me veshkat ose që kanë patur një transplant të organeve.

-Komunikoni me mjekun në qoftëse po trajtoheni me kortizone (barna si: idrokortizon, prednizolon) ose nëse duhet të merrni një trajtim me barna kortizonik. Dëmtimi i tendinave është më i shprehur nëse merrni njëkohësisht një bar të klasës së kortizoneve dhe flourkinoloneve.

-Nuk duhet përdorur bari i klasës së flourkinoloneve në qoftëse ka shfaqur efekte të padëshiruara nga përdorimi i mëparshëm i barnave flourkinolon ose kinolon dhe këtë duhet t'ja komunikoni mjekut dhe farmacistit tuaj.

-Nëse keni ndonjë dyshim ose problem nga këto barna, duhet të flisni me mjekun ose farmacistin. **Kategoritë më të riskuara**

Përdorimi i antibiotikëve që u përkasin klasës së flourkinolon-

eve, shoqërohet me efekte të padëshiruara të parikuperueshme, që mund të zgjasin (muaj, vite) dhe prekin organet ose sistemet. Efektet e padëshiruara serioze prekin tendinat, japin arratgj, dhimbje të ekstremiteteve, debulesë, neuropati e shoqëruar me parastezi, depresion, lodhje,

shqetësime të gjumit, dëgjimit, shikimit, shijuarit dhe ndjeshmërisë. Dëmtimet e tendinave (në mënyrë të veçantë tendina e Akilit, por dhe tendinat e tjera) mund të vihen re brenda 48 orëve të para të fillimit të trajtimit me flourkinolone, por dëmtimet mund të ndodhin edhe disa muaj pas përfundimit të

trajtimit. Pacientët e moshuar me probleme renale ose që kanë patur një transplant të organeve dhe që kanë qenë në trajtim me barna kortizonik, paraqesin risk të lartë të dëmtimeve të tendinave. Te pacientët e kësaj grupliste administrimi i njëkohësishëm i kortizonëve me flourkinolon duhet evituar. Me shfaqjen e shenjave të para si dhimbje të tendinave ose inflamacione, pacientët duhet të njoftohen të ndërpresin trajtimin me flourkinolone. Pacientët të jenë në kontakt me mjekun në rast të simptomave të neuropatisë si dhimbje, djegie, ndjesi shpuese në këmbë, lodhje. Fluorkinolonet nuk duhen përdorur në përgjithësi nga pacientët që kanë pasur efekte të padëshiruara të parikuperueshme nga përdorimi i barnave të klasës së kinoloneve e flourkinoloneve. Nga përmbledhjet e karakteristikave të produktit të përditësuar duhet të verifikohen indikacionet e autorizuara se kur duhet të merret në konsideratë trajtimi me një bar të klasës së flourkinoloneve, për arsye se këto barna kanë indikacione të kufizuara. Përfitimet risk-benefit të klasës flourkinoloneve do të jenë të monitoruara në vazhdimësi dhe studimi i barit do të shërbejë në vlerësimin e efektivitetit të masave të reja që duhen marrë për kufizimin e përdorimit të kësaj klase.





# Këshilla



## Efektet e mrekullueshme të vajit të lirit në organizëm

**F**arat e lirit bëjnë pjesë në grupin e ushqimeve më të fuqishme për efektet e dobishme në trupin tonë: nga ato terapeutike të vetitë estetike për kujdesin e lëkurës dhe flokëve. Vaji i farës së lirit është përdorur si një anti-inflamator, antioksidant dhe vasoprotektor, pra si një koncentrat i virtyeteve që duhet të zbulohen. Vaji i lirit është një antioksidant i fuqishëm dhe anti-rrudhë: në sajë të përmbajtjes së saj të Omega 3 dhe Omega 6 është e dobishme në ruajtjen e cilësisë së qelizave dhe indeve dhe për këtë arsye një anti-moshë e shkëlqyer. Për rutinën e bukurisë mund të përdoret si një mbartës për grimin: vetëm disa pika në një shtupë pam-buku janë të mjaftueshme për të hequr përbërjen në një mënyrë të natyrshme dhe efektive. Kundër rrudhave rreth syve apo rreth buzëve, përdorni vetëm disa pika çdo ditë me një masazh të butë në zonën e prekur. Vaji është gjithashtu i shkëlqyer kundër shenjave në lëkurë si ato që shfaqen pas një dobësimi shumë të shpejtë. Vaji i farës së lirit është një aleat i çmuar për bukurinë dhe shëndetin e flokëve tonë, si dhe për të parandaluar formimin e fijeve dyshe të flokëve. Në sajë të përmbajtjes së lartë të acidit linoleik, i dobishëm në hidratimin e flokëve që rregullojnë humbjen e ujit, dhe tek alfa acid linoleik, i cili mban elasticitetin dhe rezistencën e tij, vaji i lirit ka vlerat e jashtëzakonshme të ris-

strukturimit. Për ta përdorur atë është e mjaftueshme për të përzier tre lugë qumësht me një vaj liri, e përziejme dhe e zbatojmë, e lëmë të veprojë për gjysmë ore dhe pastaj e shpëlajmë me ujë të ngrohtë. Me të vërtetë i shkëlqyeshëm si një strukturim, përforsim dhe shkëlqim flokësh. Gjithahstu vaji i farës së lirit është një ndihmë e madhe për të luftuar gjendjet inflamatore. Palë acideve esenciale që përmban, të cilat trupi ynë nuk mund t'i prodhojë vetë, ndihmon trupin të eliminojë toksinat dhe të rrisë sistemin imunitar dhe përdoret me vlef-

shmëri për trajtimin e ekzemës dhe psoriazës, në sajë të vetive shëruese dhe anti-inflamatore. Kur aplikohet në lëkurë, ky vaj i mrekullueshëm ka veti qetësuese, ushqyese, lehtësuese, shëruese dhe hidratuese. Ndërkohë vaji i farës së lirit përdoret edhe në kardiologji. Sipas disa studimeve shkencore, acidi alfa-linolenik, që vaji i farës së lirit është veçanërisht i pasur, funksionon shumë mirë si kardioprotektor dhe vasoprotektor dhe ka një veprim të rëndësishëm anti-hipertensiv.



## Kërpudhat, ilaç kundër depresionit

Një zbulim nga studiuesit e Imperial College London ka arritur në përfundimin se konsumimi i Kërpudhave Magjike ndihmojnë pacientët me depresion që të rigjenerojnë trurin. Shkencëtarët shpjegojnë se kjo kërpudhë ka në përbërjen e saj dhe Psilocybin e cila ka një efekt pozitiv në shëndetin mendor. Mikrodozat e kësaj substance i bënë njerëzit të ndihen më energjikë, iu largon frikën, ankthin. Studiuesit i bazuan hulumtimet e tyre tek 20 pacient të cilët vuanin nga depresioni dhe që nuk kishin shfaqur përmirësim nga kurimet antidepressive. Pacientët në javën e parë morë një dozë prej 10mg të psilocybin nëpërmjet kërpudhave magjike dhe javën e dytë e çuan dozën në 25mg. Të gjithë të sëmuretë nisën të ndiheshin më mirë që një javë pas trajtimit. Megjithatë studiuesit shpjegojnë se ky zbulim është thjesht një vështrim i lehtë mbi efektet e Kërpudhës Magjike dhe se pritet që vitin tjetër të realizojnë një studim me të gjerë për mrekullitë që mund të bëjë kjo bimë. Kërpudhat gjithashtu kanë në përbërjen e tyre shumë vitamina e nutrientë, kanë pak yndyrë, pak kripë, si dhe pak kalori. Ato janë të mbushura edhe antioksidues, ndërkaq kërpudhat si ushqim njihen se ju mbrojnë nga dëmet e plakjes dhe forcojnë sistemin imunitar.



**Spanja në ankth, vogëlushi prej një jave nën thellësinë 107 metra**

**'Në luftë me kohën', operacion shpëtimi me 300 njerëz për 2-vjeçarin që ra në pus**

Vogëlushi dyvjeçar, Julien Roselló, i cili ka rënë brenda një pusi, po mban nën tension Spanjën. Ekipeve të shpëtimit janë ende në përpjekje për të gjetur të miturin që ra brenda pusit të ngushtë dhe të thellë 107 metra, në Spanjën jugore 7 ditë më parë. Asnjë shenjë jetë të 2-vjeçarit nuk është zbuluar deri me sot nga pusi në qytezën Totalan, në lindje të Malagës. Treqind persona punojnë me turne nga 100 vetë çdo tetë ore, ndërka kodra ku ndodhet fëmija ngjan me një kantier gji-



gand ku mjete të tonazhit të rëndë punojnë pa pushim Ata gjetën brenda pusit flokë dhe testet e ADN-së konfir-

mojnë se janë të fëmijës. Flokët u gjetën në mesin e mbeturinave të nxjerra nga pusi dhe u krahasuan me mostrat e ADN-së nga shishet e ujit të djalit. Brenda pusit të ngushtë me diametër 25 centimetra nuk mund të futet asnjë njeri. Në 70 metra thellësi është një pengesë, e cila nuk lejon ekipin e shpëtimit të dërgojnë ushqim dhe ujë për tek fëmija. Të shtunën Kryeinxhinieri Angel Vidal tha se ekipi është i motivuar për të arritur sa më shpejt

tek djali. Orët e gjata në punë, mungesa e gjumit dhe lodhja nuk e demotivojnë ekipin. "Kemi shpresë se do ta shpëtojmë dhe do t'ua çojmë prindërve. Operacioni pritet të përfundojë të hënë. Ai është fëmija i të gjithëve, do ta nxjerrim jashtë". - ka thënë ai. Inxhinieret kanë projektuar dy tunele horizontal dhe vertikal për të arritur tek fëmija. Do të jenë minatorë të specializuar ata që do të futen për të kërkuar në vendin ku besohet se ka rënë fëmija. Sapo të përfundojë tuneli i parë ekipi i shpëtimit do të ndërtojë një tunel të dytë të shkurtër për të arritur zonën ku fëmija ka ngecur. **"The Jerusalem Post" - Bota.al**



**SHKURT**  
**Britani, burg nëse bën foto nën fundin e femrave**

Një projekt ligji i ri i miratuar nga parlamenti në Britaninë e Madhe ka ngjallur mjaft debate. Projektligji i ri synon të ndëshkojë deri në dy vite burg personat që bëjnë një foto nën fundet e grave. Ky ligj pret tashmë vetëm nënshkrimin nga mbretëresha Elizabeth II, etapa e fundit e procesit legjislativ në Britaninë e Madhe, për t'u miratuar plotësisht. Ai u paraqit pas një fushate të zhvilluar nga Gina Martin, një vajzë 27 vjeçe, e cila ka qenë vetë viktimë e kësaj praktike që përshkruhet nga termi anglisht "upskirting" (poshtë fundit). Dy persona i kishin bërë asaj një foto nën fund gjatë një festivali në Londër në vitin 2017 dhe më pas e kishin shpërndarë foton nga telefonat e tyre. Vajza kishte kërkuar ndihmën e policisë, por asnjë ndjekje nuk ishte bërë për mungesë të një akuzë konkrete.

**SHBA dërgon luftanije në Detin e Zi**

Marina amerikane tha se luftanija USS Donald Cook është nisur drejt Detit të Zi për të kryer operacione të sigurisë detare dhe për të përmirësuar stabilitetin detar me aleatët e NATO-s në rajon. Luftanija amerikane, që ka kapacitet për të shkatërruar raketa, ishte duke lundruar në Ngushticën e Dardaneleve në Turqi më 19 janar, kur u nis drejt Detit të Zi. Njoftoi marina amerikane përmes një deklarate. "Marina amerikane operon në Detin e Zi jo përputhje me Konventën e Montreut dhe ligjit ndërkombëtar", thuhet në njoftim. Autoritetet amerikane nuk dhanë ndonjë datë se kur luftanija do të arrijë në Detin e Zi, por agjencia ruse e lajmeve TASS, citoi Qendrën e Kontrollit të Ministrisë së Mbrojtjes së Rusisë të ketë thënë se është duke "vëzhguar lëvizjet" e luftanijes USS Donald Cook, që sipas konventës ndërkombëtare, mund të qëndrojë në Detin e Zi jo më shumë se 21 ditë. Tensionet në rajon janë rritur që nga 25 nëntori, kur forcat ruse të sigurisë kapën tri anije ruse pranë Ngushticës së Kërçit, që lidh Detin e Zi me Detin Azov.

**Demokracitë s'po luftojnë kundër atyre që shtypin mendimin ndryshe**

**Kontrolli i mediave sociale, regjimet totalitare do shkatërrojnë Perëndimin**

*Të gjithë të monitoruar, kompanitë teknologjike 'pro' ndrydhjes*



Në shekullin XX-të, regjimet totalitare ishin në disavantazh ndaj demokracive, pasi publiku i tyre ishte në gjendje të importonte materiale disidente nga demokracitë. Diktatura e kishte të vështirë të kontrollonte zërat ndryshe, apo të kërcënonte disidentët që jetonin në vende demokratike, pasi mekanizmat e censurës sabotoheshin nga metoda e shpërndarjes së informacionit. Për shkak se demokracitë kanë prirje të kenë më shumë media, nga vetë natyra e konkurrencës së brendshme, diktaturat në shekullin XX ndodheshin shpesh nën rrethim, duke u përpjekur të ruanin informacionin që hynte në vendin e tyre. Kufijtë porozë, valët e radios dhe metoda të tjera u mundësuan njerëzve, të mësonin se çfarë po ndodhte jashtë shteteve të ndryshme politike, sikurse ishte Perandoria Sovjetike. Në shekullin XXI situata është përbërë. Diktatura u kërcënua fillimisht nga interneti. Papritmas, publiku kishte qasje në të gjitha llojet e informacionit. Faqet e internetit, u shfaqën në gjuhë të ndryshme. Mediat sociale, i mundësuan njerëzve në vende si Irani, të komunikojnë me botën e jashtme. Por udhëheqësit totalitarë, e kuptuan shpejt se potenciali më i madh i internetit, ishte, gjithashtu, dobësia e tij. Nënshtrësa e butë e internetit, është se të gjithë janë papritur online, dhe mund të monitorohen, gjurmohen dhe të gjenden. Për shembull, në vend se të qëndrojnë të fshehur, me libra dhe ide të ndaluar, njerëzit janë tashmë online, dhe idetë e tyre janë aty, për t'u parë nga të gjithë. Ajo që i nevojitet një qeveritë, janë disa programe për të monitoruar atë që ata thonë, dhe pastaj një mënyrë për t'i gjetur ata. Por qeveritë totalitare nuk kufizohen vetëm tek përgjimi i njerëzve. Ata më pas i mbyllin faqet opozitare të internetit apo të disidentëve brenda kufijve të tyre. Ata ndjekin penalisht botuesit dhe gazetarët. Për shembull, një raport i ri nga

Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve, tregon se në mbarë botën ka 251 gazetarë të burgosur. Ai quan Turqinë, Kinën, Arabinë Saudite dhe Egjiptin si burgjet më të mëdha. Irani është, gjithashtu, një nga shtypësit kryesorë. Sipas raporteve më të fundit, blogeri Vahid Sajadi Nasir, vdiq në një grevë urie në një burg iranian. Megjithatë mediat perëndimore, i nxjerrin në pah këto histori, siç është revista Time që i kushton gazetarëve çmimin "personin e vitit", realiteti është se demokracitë nuk po luftojnë kundër regjimeve që shtypin mendimin ndryshe. Këtë mund ta shohim në sjelljen e gigantëve teknologjikë, me qendër në Perëndim. Mediat sociale dhe gjigandët e kërkimit në internet, duhet t'i ndihmonin njerëzit të ndërvepronin në nivel global, dhe si të tillë duhet të kishin qenë platforma të lirë. Por ajo që po

ndodh realisht, është që këta gjigantë të teknologjisë bashkëpunojnë me regjime të ndryshme, duke përfshirë edhe burgjet më të mëdha të gazetarëve, për të menaxhuar përbajtjet në bashkëpunim me regjimet. Ky është një proces i errët, detajet e të cilit nuk janë zbuluar plotësisht. Demokracitë perëndimore, të cilat kanë për detyrë të mbrojnë përbajtjet në mediat sociale, që janë botuesit më të mëdhenj të përbajtjes, kanë hequr dorë nga përgjegjësitë e tyre për të kërkuar transparencë. Për shembull, me nuk e dimë pse disa postime në Facebook, nuk shihen nga njerëzit në listën e "miqve" tuaj, apo edhe nga njerëzit që "ndjekin" dhe "pëlqejnë" faqen tënde. Këta gjigantë, kontrollojnë tani më shumë informacione, sesa kompanitë e mediave tradicionale kanë kontrolluar ndonjëherë në histori. Në fakt, ata nuk bashkëpunojnë

me qeveritë, dhe postimet kritike ndaj disa qeverive marrin etiketimin "politik" dhe nuk u tregohen njerëzve. Edhe nëse doni të mësoni rreth abuzimeve të të drejtave të njeriut në disa vende, është gjithnjë e më shumë e vështirë. Kështu fitojnë regjimet totalitare. Duke përdorur teknologjinë e tij, ata jo vetëm i burgosin të gjithë blogerët dhe mendimtarët e lirë në vendin e tyre, por bashkëpunojnë me gjigantët e mediave të mëdha sociale në Perëndim, për të ndaluar ose zvogëluar kritikën kudo në platformë. Ata, gjithashtu, "raportojnë" për përdoruesit që janë kritikë, duke ua ndaluar atyre nëpërmjet kërkesave direkte gjigantit të medias sociale, ose duke përdorur një grup robotësh për të raportuar njëherazi të njëjtat profile. Gjithnjë e më shumë, lufta po zhvillohet në internet midis regjimeve të ndryshme dhe ushtrive të tyre "virtuale", që targetojnë përdoruesit të cilët janë kritikë. Nuk ka thuar asnjë reagim nga demokracitë. Qeveritë në Perëndim, nuk e kanë kuptuar se si po zhvillohet kjo luftë e re, dhe po e shpërdorojnë mundësinë për të zbuluar se si gjigantët e mediave të tyre sociale, janë gjithnjë e më shumë partnerë me qeveritë e huaja për të shtypur përbajtjet. Ata nuk po përpjejnë të mbrojnë publikun nga kjo shtypje, apo të krijojnë një "Bill of Rights" për përdorimin e internetit. Përkundrazi, ata po lejojnë që individët opozitarë të shënjestrohen një e nga një. Në çdo hap, po shohim se si teknologjia e

re ka i mundësuar regjimeve të gjejnë disidentët jashtë vendit, të përdorin mjete të ndryshme për t'i bllokuar qasjen e tyre në mediat sociale. Këto regjime nuk mund të ndalojnë faqet të veçanta të internetit, që ndodhen jashtë vendit, por ata mund ta bëjnë atë që askush të mos i shohë këto faqe interneti. Kjo është gjithnjë e më e lehtë. Ju nuk keni nevojë të ndaloni informacionin, nëse mund ta bëni atë të vështirë për ta gjetur. Dhe kompanitë e mëdha të teknologjisë u japin regjimeve totalitare mjetet për ta bërë këtë, qoftë drejtpërdrejt, nëpërmjet partneriteteve, ose në mënyrë indirekte, duke u lejuar regjimeve të shfrytëzojnë platformat e tyre. Gjigantët e mediave sociale, janë shpesh të ngadalta për të reaguar. Ato mund të përballen me ekstremizmin në internet, ose edhe disa llojet të ndryshme të ndërhyrjeve të huaja në zgjedhje. Por nga vetë natyra e tyre këto kompani të mëdha, po i pengojnë gjithashtu anëtarët të shohin informacionet që dëshirojnë. Ata gjithnjë e më shumë mendojnë se e dinë se çfarë është "më e mira" për përdoruesit, dhe u tregojnë atyre përbajtjet, që ata mendojnë se është "më interesante". Në fakt, po i çelësojnë disa postime popullore si "jo interesante", dhe thjesht nuk u tregojnë atyre njerëzve që kërkojnë në mënyrë aktive t'i japin "like". Kur dikush do të pyesë në të ardhmen se si ia dolën mbanë regjimet totalitare në shekullin XXI, duhet t'i thuhet se ndodhi kështu. Jo në hije, por hapur.

Opinioni *i* Ditës

# Demonizim, dekomunistizim

Nga Silvi Bakiri

(vijon nga faqja 1)

Departamenti i shpifjeve duhet të jetë strukturë e pandashme e çdo partie politike, thujtë si organizatë jopartiake, gati për të mbrojtur çdo qytetar që sulmohet pa asnjë të drejtë në intimitetin dhe privatësinë e tij. Një strukturë shumëfunktionale edhe për qytetarë edhe për parti, që mund të shkokoletë nyjet e tmerrit që kanë kapluar studentët, punonjësit, të papunët, të punësuarit jashtë vendit. Mashtruesit dhe të mashtruesit, gjithashtu. Për ta kthyer vendin në një shtet model, joskajor, ku së paku të jetë i pranishëm një farë intelektit dhe ku të mbizotërojë mirësia.

Për gratë. Për burrat. Jam më tepër se e bindur që emërues partneriteti mes tyre, mes nesh, mbetet të qëndruarit sa më larg lumenjve llumë; si sovranë të jetëve tona. Kjo, mund të kalibrohet gjithashtu edhe ëndrrat e qindra mijëra emigrantëve.

Mund t'i bindë të shpresojnë, të votojnë, të luftojnë për kauza që vlejnë.

Në vendin e tyre, aspak në ngrica tokash të huaja, nëse nuk është gjëja e duhur.

Sa e kuptojmë këtë? E thënë ndryshe: A nuk është komunikimi ajo çka i duhet çdo individit për të kuptuar? Larg injorancës si telefon i prishur.

Gjatë viteve të komunizmit



njerëzit ishin të shtrënguar të pranin.

'My way' nuk ekzistonte, e si i tillë nuk ekzistonte të zgjedhurit e fatit tënd. Gjatë viteve '90 e tutje, demokracia vinte shpejt me tendencën për të shënjuar hapa të saktë në mënyrën se si do të zhvillohej.

Vështirë të kuptohet të qenit njeri i lirë, artist, shpirt shtegues, i pacënueshëm nga mentalitete, shtrëngesa apo urdhëresa të kota. Disa, veçanërisht brezi im (tash' 30 vjeç) kështu, e shihte demokracinë: Të ndjerit i lirshëm, si zog por me dinjitetin dhe pozicionim sipas meritokracisë. Një tjetër verb ardhur prej konceptit të iniciativës së lirë.

Sipas meje, demokracia ka një sekret si shumica e gjërave: Nëse nuk e beson, të kthen shpinën! Me kusht që të jetë e vërtetë. Dekomunistizimi i mendjeve mund të jetë reforma e 2019-ës! : Pa i demonizuar (krijuar imazhe të tjetërsuara për persona të caktuar: për t'i kthyer në akullnaja, edhe për familjen). Sërish, rrezik i demokracisë ky problem.

Protestat e studentëve sot tregojnë për etjen që ka vendi përgjithësisht për t'u përmirësuar, për t'u pasuruar dhe për të parë përpara. Për të buzëqeshur me të djeshmen dhe për t'i dhuruar hapësira kujtë talenti; që secili të mund të thotë:

"Këtë e kam bërë unë! Por, ti mund ta shohësh, edhe duke kontribuar."

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS



Opinion i Ditës

# Ramushi, taksa dhe të tjerët!

Nga Arian Galdini

(vijon nga faqja 1)

...ndryshojnë thelbësisht nga ato të politikanëve që vjedhin histori.

Politikani që vjedh histori, bëhet pjesë dhe aktor lojërash dhe skenarësh.

Lideri që bën histori, bëhet mbrojtës i vendosur parimesh dhe vlerash.

Politikani që vjedh histori, zbaton veç skenarë e paguhet apo paguan për përmbushjen e tyre.

Lideri që bën histori, ecën përpara mes të papriturave dhe merr vendime të forta atëherë kur mjegulla është më e dendur e humnera krejt pranë.

Politikani që vjedh histori nuk ka miq, por veç skenaristë, regjisorë, producentë dhe kastën e aktorëve të përzgjedhur që të luajnë pjesën së bashku.

Lideri që bën histori ka miq dhe partnerë besnikë.

Të thëna të gjitha këto, po them pse Ramush Haradinaj është lideri që po bën histori në Kosovë.

Sepse Ramush Haradinaj ka marrë një vendim strategjikisht të mençur, ndonëse me rrezikshmëri e kundërshti të lartë kur ka vendosur taksën 100% për produktet nga Serbia.

Që e gjithë bota do t'i dilte kundër, kjo dihej.

Ama askush nuk mund të thotë se taksa nuk e ndryshoi thelbësisht frekuencën e qëndrimeve ndërkombëtare dhe këtu brenda nesh, mbi kuptimin dhe arsyet e dialogut Kosovë - Serbi.

Pikërisht, në një kohë kur Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, e riktheu dialogun në vitin zero dhe sikurse e thotë krejt saktë ish - ministri i Jashtëm i Shqipërisë Ditmir Bushati, në pothuajse akt suksedimi të Serbisë ndaj Kosovës, ndërhyrja e Kryeministrit Haradinaj me vendosjen e taksës, e ngriu skenarin e "shkëmbimit të kufijve".

Arritja e parë ishte ndalja faktike e vetë dialogut.

Presidenti Vuçiç mori vendim që dialogu të mos vijojë më me Presidentin Thaçi, derisa të hiqet taksa.

Sigurisht, i gjithë komuniteti ndërkombëtar u befusua dhe shqetësua nga efekti ngrirës ndaj dialogut që pati taksa.

Kështu që të gjithë duke pasur prioritet dialogun, vendosën të godasin dhe trysnojnë Kryeministrin Haradinaj.



Të gjithë, BE dhe SHBA, partnerët tanë kryesorë, nuk ia kanë kursyer e as do t'ia ndalin gjëmet e kritikave e goditjeve Kryeministrit të Kosovës Ramush Haradinaj.

Gjithçka duhet të bëjë Ramushi është të vijojë të qëndrojë e rezistojë fort në qëndrimin e tij për taksën, derisa mjegulla të shpërndahet e qartësia të vijë, e ndërkombëtarët të rikuptojnë çka dikush ua ka humbur nga pamja se Dialogu nuk po bëhet për suksedim, por për njohje reciproke dhe bashkëpunim ekonomik, kul-

turor, politik, institucional, ndër-shtetëror për një paqe të qëndrueshme dhe integrim evropian.

Ka gjithmonë momente kaosi, kur karriera politikanësh e nevoja e tyre për suksese momentale, nxit mjegull të madhe e mund të shkaktojë edhe dëme të mëdha e të pariparueshme.

P.sh., nëse znj. Mogherini dhe z. Hahn duan që deri në fund të mandatit të tyre të kenë një sukses të dukshëm, pra një marrëveshje historike Kosovë - Serbi, kjo nuk mund të bëhet ushqim për mendje e axhenda meskine

politikanësh vendas, që janë të gatshëm të japin çdo dhuratë me kusht që këta të mbeten në pushtet.

E njëjta gjë vlen edhe për z. John Bolton atje në DC.

Nëse ky zotëri, lobon fort nga Shtëpia e Bardhë deri tek ambasada e SHBA në Kosovë që të ketë një marrëveshje sipas agjendës Mogherini, kjo nuk do të thotë se ne duhet t'ia dhurojmë atij këtë kënaqësi.

Ky zotëri është proserb i njohur e i deklaruar dhe mbi të gjitha është kalimtar në atë

detyrë të lartë që ka pranë Presidentit të SHBA.

Por Kosova nuk është kalimtare.

Asnjë pëllëmbë tokë e Kosovës, nuk është kalimtare.

Kosova e ka fituar lirinë në 1999 dhe Pavarësinë në 2008, faleminderit SHBA, NATO dhe BE!

Nuk ka asnjë arsye që Kosova të kërkojë suksedim nga Serbia në 2019, për hatër të Mogherinit, Hahn dhe John Bolton.

Le t'i respektojmë këta njerëz të nderuar për detyrat e larta që kanë, por edhe t'u tregojmë se Kosova nuk vlen sa dekoratat që ata synojnë.

Qëndrimet zyrtare të BE dhe SHBA, asnjëherë nuk kanë qenë pro shkëmbimit të territoreve.

Mogherini, Hahn dhe John Bolton, si zyrtarë të BE dhe SHBA kanë folur për një parapëlqim të tyre ndaj kësaj teze.

Kancelarja Merkel ka qenë vendosmërisht e prerë kundër idesë së shkëmbimit të territoreve.

Edhe Sekretari i Shtetit Pompeo dhe Ambasadori i SHBA në Kosovë z.Kosnet, kanë deklaruar disa herë se SHBA nuk ka ndryshuar qëndrim në raport me Kosovën, e se SHBA mbështet një marrëveshje Kosovë - Serbi, por jo çdo lloj marrëveshjeje.

Mjegulla e madhe që ka shkakuar qëndrimi i Mogherinit, Hahn dhe John Boltonit do të fashitet shumë shpejt.

Shkëmbim kufijsh nuk do të ketë.

Trysnia ndaj Ramushit, kundër taksës 100% për produktet serbe, do të vijë e bëhet më e ashpër derisa të fashitet e gjitha pas pak javësh.

Ramushi duhet të rezistojë derisa të gjithë ta kuptojnë se taksa nuk është kundër Dialogut e as kundër Marrëveshjes, por është kundër suksedimit.

Do ta kuptojnë.

BE dhe SHBA do të flasin qartë pro një marrëveshjeje historike Kosovë - Serbi për njohje reciproke dhe bashkëpunim, por jo të lejojnë ka politikanë batakcinj që të vjedhin historinë duke shkëmbyer territore.

Ramushi dhe të gjithë ne jemi pro dialogut dhe pro një marrëveshjeje historike Kosovë - Serbi.

Taksa vetëm po ndihmon që të shuhet mjegulla e krijuar e të rikuptohet thelbi dhe motivi i vërtetë i dialogut dhe marrëveshjes.



**BLUE TOOTH**

THASHETHEME  
MADE IN  
ALBANIA



te rejat  
nga jeta  
ipave

çdo të shtunë falas me



Opinioni *i* Ditës

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... jo të zakonata që gati pa fare baza mbinë tek disa politikanë, sidomos të opozitës, por edhe mes shumë njerëzve të zakonshëm, thjesht të pakënaqur me sa e ka "ndritur" deri tani Rilindja. Ide se mos mes drejtuesve të pozitës së sotme ka grupazhe. Ka grupe interesi me dëshira dhe plane ende të mbajtura fshehur brenda Partisë Socialiste. Kjo jo vetëm ndezi oreksin e një opozite të papjekur dhe të etur për pushtet, e cila shpresoi se mund të shfrytëzonte çarjet mes socialistëve për diversion (pështjellim), sipas thënies së vjetër romake "Devida ed impera (përça e sundo)", por furnizoi edhe fantazitë e njerëzve të zakonshëm. Të cilët, ndërsa gjerbnin kafenë e mëngjesit apo pasditës, nisën të flasin për grupazhe mes socialistëve, për shembull për atë të dyshes Veliaj-Xhafaj kundër Ramës. E gjitha ishte prodhim i dinakërisë së një kryeministri të shndërruar tashmë në një krijesë të plotë politike, i cili bënte enkas sikur hezitonte. Në të vërtetë, duke menduar politikisht, duke larguar nga vetja çdo lloj xhelozie, bezdie për kashillëk apo smirë ndaj dikujt që po bën gati edhe më mirë për kryeqytetin nga sa ka bërë ai në mandatin e tij të parë 2000-2003, drejtuesi i shumicës së sotme në pushtet e kupon qartë vlerën e dikur beniaminit të vet. Është aq i kthjellët (edhe pas ftohjes disi të pasionit fluturak të Rilindjes), sa të kuptojë se hambarin më të madh të votave pas pensionistëve, si për garën e qershorit 2019, edhe për atë të dy viteve e gjysmë më vonë, e përbën puna e kryetarit të sotëm të bashkisë së kryeqytetit. Ky ka mbjellë pemë më shumë se të gjithë kryetarët e të gjitha bashkive të vendit të marrë së bashku dhe më shumë edhe se të 5 kryetarët e bashkisë së Tiranës përpara tij (njeri, kryeministri i sotëm, me tre mandate rresht). Ka shtruar pothuajse të gjitha rrugët dytësore të Tiranës, duke e bërë një qytet të jetueshëm. Ka sjellë shërbime të reja publike, duke enisur nga linjat e reja të autobusëve deri tek vaktet falas të organizuar për të pastrehët. Ka sjellë më shumë ndriçim, shfaqje kulturore dhe sportive se të gjithë kryebashkiakët e mëparshëm. Zotëron një stil pune që motivon të rinjtë, njerëzit me ide dhe profesionistët. Di të delegojë, të japë besim, të investojë mbi menexherët që angazhon, pa u bërë domosdoshmërisht zot i të gjithë informacionit dhe i çdo vendim-marrje. Kur shërbeu për më pak se dy vjet ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, la në punë njerëzit e aftë të qeverisjes së mëparshme të demokratëve. Edhe pse ministër për një gjysmë mandati, mund të renditet ndër ministrat më të zotë dhe rezultativë që kemi patur ndonjëherë në këta 28 vjet e fundit, në rangun e Genc Rulit apo Ridvan Bodes. Madje ndryshe nga këta, di të jetë më veprues dhe t'u shkojë gjërave deri në fund. Si ministër, nisi një reformë tejet të vështirë e të gjatë të skemës së pensioneve, të cilën për 22 vjet nuk kishin guxuar ta fillonin me radhë të gjitha qeveritë që nga viti 1992 e deri në 2013, nga frika e bjerrjes së votave. Kur la punën si ministër, për të garuar për Tiranën, reformën në skemën e pensioneve e

# Të largoj pulën e florinjte?!



Ka mbjellë pemë më shumë se të gjithë kryetarët e të gjitha bashkive të vendit të marrë së bashku dhe më shumë edhe se të 5 kryetarët e bashkisë së Tiranës përpara tij (njeri, kryeministri i sotëm, me tre mandate rresht). Ka shtruar pothuajse të gjitha rrugët dytësore të Tiranës, duke e bërë një qytet të jetueshëm. Ka sjellë shërbime të reja publike, duke enisur nga linjat e reja të autobusëve deri tek vaktet falas të organizuar për të pastrehët. Ka sjellë më shumë ndriçim, shfaqje kulturore dhe sportive se të gjithë kryebashkiakët e mëparshëm. Zotëron një stil pune që motivon të rinjtë, njerëzit me ide dhe profesionistët.

hëngri dreqi. Ka ngelur në vendnumëro. Këtë pulë të florinjte as edhe një politikan i paparashikueshëm dhe jo rrallë herë peng humoresh të çastit si kryeministri i sotëm, nuk mund të mos e përfillë. Ditët e fundit, nëpër media, sa për të ngjallur pështjellim në radhët e opozitës (por jo pak ngriti edhe kureshtjet e qytetarëve), bëri sikur ngurronte se kë do të caktonte garues për Tiranën. Ishte një tallje e egër ndaj një opozite të papjekur dhe të papërgjegjshme për misionin e vet. Po ta kishte seriozisht, të injoronte, të linte mënjanë pulën e tij të florinjte, do t'i ngjante marangozit që sharon degën ku ka hipur në këto tre vite e gjysmë. Sigurisht që një njeri i plotë politik, si drejtuesi i sotëm i shumicës në qeverisje, nuk mund ta bënte këtë hakirri. Dhe nuk e bëri.

## HOROSKOPI

**DASHI**  
Idetë e reja nuk rriten në pemë dhe në këto momente, ato duket se nuk po rriten as në mendjen tuaj. Nëse ndjeni se keni mungesë kreativiteti, bëni një shëtitje dhe, gjithashtu, këshilloheni që të mos i bëni gjërat me zor. Truri mund të ketë nevojë për pushim.

**DEMI**  
Nuk bëni asnjë gabim nëse ndërmerrni rreziq sot. Universi nuk do t'ju dënojë për guximin. Ju mund t'i shtyni gjërat mjaft larg, por përfundimisht do të përballeni me pengesa. Arritja e këtij kufiri do të jetë interesante.

**BINJAKET**  
Kjo do të jetë një ditë e mbushur me fillime të forta, por do të mungojë vijmësia. Sidoqoftë, nuk do të jetë shumë të shqetësuar për vazhdimin e punës në projektet tuaja kur ju jeni të rrethuar nga kaq shumë njerëz që doni. Shijoni këtë kohë.

**GAFORJA**  
Sot njerëzit që keni përreth mund të përballen me anën tuaj më irrituese. Nuk ka asgjë të keqe që të tjerët të shikojnë të gjitha ngjyrat e karakterit tuaj. Padyshim, përpikuni të mos tronditni personat e dashur.

**LUANI**  
Të qenit i përfshirë në grupe do të sjellë shumë kënaqësi për ju sot. Duhet punë e fortë në grup për të bërë një përshytyje të madhe ndonjëherë dhe do të jeni me fat që të jeni në një skuadër që me të vërtetë e di se si të terheqë vëmendje. Merrni më shumë angazhime se zakonisht.

**VIERGJERESHA**  
Një energji intensive do t'ju mundësojë të kryeni punë jashtëzakonisht të detajuar. Kujdesuni për gabimet e vogla dhe të paqëndrueshme të njerëzve të tjerë sot dhe mos u ndjeni në siklet për të kërkuar korrigjime dhe rregullime.

**PESHORJA**  
Zbulimi i pasionit tuaj mund të krijojë një lidhje me dikë që dëshironi të jeni më afër. Mos hezitoni të flisni hapur rreth gjërave që për zemër. Mund ta gjeni veten pranë personit që ndan të njëjtat dëshirë me ju.

**AKREPI**  
Njerëzit duhet të tronditen nga vetëkënaqësia e tyre dhe të zgjohen nga rutinat e tyre të përgjumura. Vetëm kështu mund të arriji që të largoni rutinën dhe të arriji suksesin që kërkoni prej shumë kohësh.

**SHIGJETARI**  
Sot do të jeni plot kontraste. Ndërsa do të keni dëshirë të fortë për t'u treguar filozofik me miqtë tuaj, ju nuk do të jeni në gjendje të lidheni vërtet me ta për biseda të thella. Mendjet e tyre do të jenë diku tjetër.

**BRICJAPI**  
Do të karakterizoheni nga një bukurri verbuese sot duke ju mundësuar që të tërhiqni shumë njerëz të ndryshëm. Shfrytëzojeni këtë moment për të njohur njerëz që mund të kenë ndikim të gjatë në jetën tuaj.

**UJORI**  
Njerëzit që janë dukur interesantë sot do të mendojnë se personi interesant në fakt jeni ju. Sot është koha për të analizuar një koncept të vështirë i cili ju ka intriguar prej shumë kohësh dhe që ka të bëjë me dashurinë.

**PESHQIT**  
Sa herë që jeni në dyshim se çfarë duhet bërë sot, bëni një pauzë. Kjo nuk është një ditë e mirë për të ecur përpara me projektet apo një marrëdhënie. Nuk gaboni nëse i jepni vetes kohë për rigjenerim.



**Berisha e Gjimeshiti ndër më të mirët e ekipit**

**Shpartalluan Frosinonen, vlerësim mjaft i mirë për kuqezinjtë**

Mesditën e djeshme Atalanta shkatërroi Frosinonen me rezultatin e thellë 0-5, ku në fushë titullarë ishin Berisha dhe Gjimeshiti, të cilët kanë marrë vlerësime pozitive nga mediat italiane. Sipas "Tuttomercato.web", të dy futbollistët e Kombëtares morën notën 6.5 dhe janë vlerësuar me fjalë të mira. Për portierin kuqezi thuhet: "Praktikisht i papunë për 60 minuta, përveç disa pritjeve. Ai vendosi shpatullat e tij në lojën e sotme në "Pinamonti". Ndërsa për Berat Gjimeshitin dhe 83 minutat që luajti, gjithashtu, fjalët ishin pozitive: "Nuk kishte shumë

punë, por hoqi topin në gjuajtjen me kokë të Kambell dhe i dha topin Zapatas për golin e tretë". Një sfidë shumë e mirë për lojtarët kuqezi, të cilët i kanë dhënë një shtysë ekipit të tyre për këtë fitore që i bën të ndërrojnë për zonën Champions.

Objektivat e ndryshëm me klubin, një ekip pa motivim dhe dëshirë, ja vështirësitë e teknikut

**MESFUSHORII KUKËSIT**



**Çyrbja: Kemi presion, por triumfojmë ne**

Kukësi po zhvillon për gatitjet e fundit në prag të takimit të Kupës ndaj Apolonisë. Faza përgatitore e zhvilluar në Antalia, është konsideruar si pozitive nga mesfushori Arbër Çyrbja, i cili shënoi 3 gola në 3 ndeshjet e zhvilluara. Në një prononcim për "SuperSport", Çyrbja e ka pranuar se skuadra e ka presionin, por aq sa e ka norma, ndërkohë që ka besim se Kukësi mund t'ia dalë. "Faza në Antalia? Askush nuk e di çfarë ndodh, por shqyr që dolëm mirë dhe në të gjitha ndeshjet bëmë lojë të mirë. Ndihem shumë mirë dhe kemi lojtarë të mirë. Është e vërtetë që ekipet janë pak a shumë njëlloj si Partizani, si Teuta, si Skënderbeu janë shumë afër, por besoj se deri në fund do t'ia dalim. Presioni? Si çdo ekip që pretendon ka presion dhe është presion normal".



**Jeton Selimi**  
**E** mori përsipër "Tironën" e tij në një kohë kur pakkush do të kishte guximin ta bënte. Por natyrisht për një si Ard Mema, që jetën e ka të lidhur me ngjyrat e ekipit ku e gjithë familja e tij ka dhënë kontribut, kjo ishte një detyrë dhe njëkohësisht një përgjegjësi e madhe. Dëshira për të bërë mirë në një skuadër të trazuar dhe të brishtë nuk arriti ta mposhtë situatën e krijuar. Mema pati vështirësi të mëdha, disa humbje radhazi me përmbysje, lojtarë që nuk iu përgjigjën dhe kaosi financiar tashmë të trashëguar. Pavarësisht se e mendoi largimin disa herë nga stoli i Tiranës, sërisht ai është aty. Mbase për ta arritur shpëtimin e madh dhe kalimin e kësaj situatë të errët. Në një prononcim për "Zona Gol", tekniku bardheblu rrefen gjithçka.

**Mema: Jemi për mbijetesë, mendova dorëheqjen disa herë**

*Trajneri bardheblu bën bilancin e tij në krye të Tiranës*



Ismailgeci dhe Çelhaka. Kam pasur dilemat e mja për aktivizimin e të rinjve, për shkak të brishtësisë dhe emociioneve që kanë lojtarët e rinj. Mund të them se gjatë miqësoreve që kemi zhvilluar disa nga lojtarët e rinj kanë pasur momente loje, ku janë parqitur më mirë se shumica e lojtarëve të formacionit.

**MERKATO**

"Në ditët në vazhdim pres 1 ose 2 futbollistë, që mund të na bashkohen. Disa lojtarë të huaj kanë ardhur me vonesë, por jam i kënaqur nga faza përgatitore. Për sa i përket merkatos, kemi kohë deri në 30 janar, por nuk mund të flas me emra konkret. Në ditët në vazhdim do të shikojmë se kë mund të afrojmë. Kemi biseduar me tre futbollistë goxha cilësorë dhe po pres nga momenti në moment që bisedimet të konkretizohen. Duhet një përgjegjësi goxha e mirë, nuk mund të marr lojtarë anonim me 20 pikëpyetje nga pas. Nëse nuk marr këto futbollistë që kam menduar, nuk do të marr të tjerë".

**OBJEKTIVI**

"Në fillim kishim një problem shumë të madh me presimin e golave. Tani po mundohemi që të kemi ekipin në ekuilibër. Objektivat e mi janë dy: I pari atë që ma cakton klubi dhe i dyti objektivi që vendos çdo trajner. Kur erdha shumë njerëz kanë thënë se mund të shkojmë në kupat e Europës, por unë nuk e kam menduar këtë, doja vetëm që të nxirrja klubin nga zona e ftohtë. Jam trajneri dhe duhet të jem me këmbë në tokë. Nëse nuk dalim nga kjo zonë, nuk mund të mendojmë për gjëra të tjera."

**DORËHEQJA**

"Kam menduar tre ose katër herë dorëheqjen. Dy raste kanë qenë pas ndeshjes me Luftëtarin dhe pas humbjes ndaj Partizanit. Kur erdha nga Flamurtari këtu, mendoja se futboli shqiptar ka disnivele të vogla dhe thashë se do rregulloja diçka, por nuk ndodhi kështu. I gjithë problemi im ishte se unë nuk e kisha idenë se çfarë niveli kishin lojtarët që kisha në dispozicion."

**TIRANA NDRYSHJE**  
 "Në ditët e sotme, duhen ndarë detyrat. Trajneri të ketë pozicionin e vet, të zgjedhë lojtarët me kujdes. Të zgjedhë karakterin sportiv. Presidenti duhet të ketë detyrat e veta".  
**EMOCIONET**  
 "Jam përlotur edhe njëherë të kjo zyrë në një intervistë më parë, sepse këtu

ka shumë histori. Në atë moment, u emocionova edhe prej disa kujtimeve. Kohët kanë ndryshuar, edhe ne duhet të ndryshojmë. Nuk duhet të mbetemi nostalgjik. Duhet t'i mësojmë edhe brezat e tjerë me frymën e Tiranës. Këtë duam ne ish-futbollistët, të shkojë në krye".

**TË RINJTË**

"Filtra ka tek brezat e rinj, por duhet t'i bëhet një histori të rinjve se çfarë përfaqëson Tiranën. Të vjen keq që është shuar tradita e ndikimeve familjare, që vijnë nga familje futbollistësh, duke trashëguar këtë afekcion te brezi tjetër. Kemi disa elementë të mirë si Muçi,

**PRESIDENTI**

"Marrëdhëniet më të mira që kam në klubi i kam me presidentin. Kemi bërë biseda private më ka thënë se është duke negociuar me donatorët potencial. Janë negociata dhe mund të zgjasin gjatë. Ai ashtu si të gjithë dëshiron ta shikojë Tiranën përsëri në nivele të mëdha", u shpreh Mema.

**Bernardo Silva objektivi**

Bernardo Silva, lojtari i Manchester Sityt, është në orbitën e Realit, për të zëvendësuar Luka Modriç. Florentino Perez është i gatshëm të derdhë në arkat e klubit anglez plot 70 milionë sterlina për ta marrë portugezin në Madrid. Luka Modriç duket se nuk ka më stimuj të vazhdojë tek Reali, pasi karriera e tij është drejt viteve të fundit. Një aventurë e re do ta sjellë kroatin në formën e duhur duke e motivuar disi më shumë.



Për të flitet se Interi dhe Juventus janë të interesuara. Sipas asaj që raporton "Daily Star", te Reali kanë gjetur zëvendësuesin, i cili është portugezi Bernardo Silva, që po luan sezonin e tij të dytë tek Siti. Gjithmonë lëvizjet do të nisin në fund të këtij sezoni, pasi Guardiola vështirë të heqë dorë nga portugezi këto momente.

**Modriç në perëndim, Reali jep 70 mln për mesfushorin e Sityt**

**Dueli titull në ishull**


**Siti i përgjigjet Liverpulit, diferenca rikthehet në katër pikë**



an në pjesën e dytë të ndeshjes dhe kanë për autorë sulmuesit Stirling dhe Sane. Për golin e dytë ka pasur dyshime për pozicionin jashtë loje. Manchester Siti ka bërë detyrën dhe vazhdon të luftojë fort për titullin kampion. Diferenca prej 4 pikësh konsiderohet e rikuqerueshme për djemtë e trajnerit Guardiola.

Nuk mund të gabon Manchester Siti në ndeshjen me Huddersfieldin. Skuadra e Guardiolas ka fituar pastër, 0-3, në këtë transfertë, duke e çuar diferencën e pikëve me Liverpulit sërisht në katër. Një ndeshje e lehtë për Siti, që kaloi në avantazh pas 18 minutash lojë. Protagonist ishte mbrojtësi Danilo, i cili gjuajti nga distanca dhe topi, pas një devijimi, shkoi në rrjetë. Dy golat e tjerë për "qytetarët" u shënu-

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Mund të jetë kursimi.
- Ylli i Nostradamus.
- Tamam pa kufij.
- Ross këngëtare.
- I lashhtë.
- Është Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
- Kufijtë e lëvizjes
- I ka tek plepi.
- Paguhen për shërbim.
- Fillojnë lejen.
- Kufizojnë trotuarët.
- Bëjnë karrierë në parti.
- Thahet me bonifikim.
- Mund të jetë unik një i tillë.
- Preka komik shkorrdan.
- Fund dhjetori.
- Fillojnë aksionin.
- Ente Operative Tiranë
- Agjenci Ajrore Durrës.
- Një pjesë e dimensioneve.

- Është përfaqësuesja e Adriam Mutu.
- Kalimi në ekstreme.
- Është e re pas Krishtit.
- Shkruhet për të mos vazhduar më.
- Si i gjithë.
- Kush e thotë lutet.
- Kufij elementi.
- Është nija që preu Aleksandri i Madh.
- Një pjesë e titanëve.
- Mund të jetë kundërmuese.
- Pak titanike.

**VERTIKAL**

- Si i përshatëshëm.
- Mund të jenë fetare.
- Ai i kuq e ka një huq.
- Pak analogji.
- Është metri i rrobaqepësit.
- Një hyrje të oazit.
- Arte pa re.
- Arthur që qe dramaturg.
- Janë boshte.
- Michelangelo regjisor.
- Mund të bëjë stil të lirë.
- Ishin monedhe të Tobias.
- Është bas me katër tela.
- Pak efikasitet.
- Është marrëveshje me nota.
- Fillojnë nazet.
- Në krye të kuadrove.
- Është faqe muri.
- Një apendisit i menjëhershëm.
- Kurosawa që qe regjisor.
- Vriten nga espada.
- Është shtet aziatik.
- Edouard piktor.
- Një transporti është kamioni.
- Uni i Freud.
- Një cigan.
- Fundi i një samuraj.

**Fjalëkryqi (2)**


**HORIZONTAL**

- Fillojnë panikun.
- Gibson aktor.
- Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
- Mund të jetë trofe.
- Janë vendet si Katari
- Maureen që qe aktore.
- Janë kundërmuese.
- Mund të fitojnë etapa.
- Ushtojnë nga "ola".
- Një thirrje.
- Janë ministritë.
- Një rrugë në Paris.
- Markë cigareje.
- Është ngjinja.
- Ricciarelli soprano.
- Fillojnë sefte.
- Ente Ekonomike Sarandë.


- Mbyllin një ditar.
- Satelit i Jupiterit
- I ka tek Luani.
- Boldi komik italian.
- Është kolana në filma
- Kush e thotë lutet.
- Oxa këngëtare.
- Inicialet e Nolte aktor.
- Është tokë që... fitohet.
- Një... gjermane.

**VERTIKAL**


- Një votë në favor.
- Filozofi me eksperimentin e gomarit.
- Në hyrje makinës.
- Fillojnë lehtë.
- Irlanda në Dublin.
- Është edhe ajo e historisë.
- Një pjesë e gamiljeve
- Notat pa kufij.
- Ishin komitë.
- Ka kryeqytet Islamabad.
- Don... i Interpretuar nga Terence
- Mbyllin aktet.
- Janë përmasa.
- Gjysma e lutjes.
- Castellitto aktor.
- Inicilat e Dalí, piktor.
- Tanita këngëtare.
- Është tryzni
- Në hyrje të Europës.
- Janë rrobat për t'u larë.
- Bën mëza.
- Moreau aktore.
- Janë thika.
- Një pjesë e satelitit.
- Janë teke në sende.
- Pak marramendëse.
- I ka tek zdapi.
- Inicialet e Nolte-s.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

				9	1	7
			6	4		
	9				6	8
2					3	9
9		8				
	1	6	8		7	
	6	7			2	5
		3	5	4		1
4		8				

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

8	1	3	6	9	4	7	2	5
6	5	9	2	7	8	4	3	1
2	7	4	3	1	5	8	9	6
9	3	6	7	4	1	2	5	8
4	8	7	5	2	6	3	1	9
1	2	5	8	3	9	6	4	7
3	6	8	9	5	2	1	7	4
5	4	2	1	6	7	9	8	3
7	9	1	4	8	3	5	6	2

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

- Më e lavdërueshme është ajo grua, emri i së cilës shqiptohet më pak nga buzët e burrave, qoftë për lëvdëta, qoftë për sharje.

- Të gjithë janë në gjendje të nxjerrin përfundime, pak janë gjendje të gjykojnë.



- Shpesh në kundërshtojmë opinionin, ndërsa nuk na pëlqen vetëm toni me të cilën është shprehur ai.

- Personat që na japin besimin e tyre të plotë kujtojnë se kanë fituar kështu të drejtën që edhe ne t'u japim besimin tonë.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm



**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

A	L	E	X	S	G	P	O	A	Z	I		
M	I	S	H	N	D	O	R	E	S	H	R	
A	R	A	M	O	G	O	A	U	T	O		
M	K	I	M	N	O	V	A	K	O	N		
T	S	E	R	I	A	L	I	A	R	T	I	
P	R	E	T	E	N	D	I	M	I	O	K	
R	O	N	A	L	D	O	I	G	A	E		
M	A	L	E	N	G	O	R	E	T			
B	A	T	A	R	T	A	T	E	R	O	R	
I	R	O	N	A	C	E	M	Y				
L	T	R	I	K	E	P	A	R	O	D	I	A
L	O	I	R	A	C	O	R	O	T	K	N	
F	A	L	L	I	K	F	S	D	O	R	A	
A	D	A	M	P	A	L	I	M	I	N		
L	E	M	T	A	B	E	L	A	T	I	T	
A	T	K	A	P	I	T	U	L	L	I	M	I
N	M	A	R	I	N	A	R	I	F	I	L	
G	R	E	M	I	N	A	U	E	F	E		
A	R	I	F	D	E	N	T	I	S	T		
A	P	I	K	A	T	E	S	E	R	T	E	
G	T	I	A	T	E	M	E	T	E	O	R	E
O	S	Z	R	A	M	T	E	R				
S	H	T	E	P	I	T	E	L	E	J	A	
A	E	K	A	M	I	V	I	S	A	R	I	

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

*Thënie të mençura*

- Kush nuk di t'i vendosë mendimet e tij në akull, nuk duhet të përfshihet në nxehtësinë e debatit.
- Personave që nuk i duam ua llogarisim mirësjelljet që shfaqin ndaj nesh si fyetje.

- Askush nuk i është mirënjohës njeriut me shpirt.
- të madh për mirësjelljen e tij, kur ky i përshatet.
- një shoqërie ku nuk është e sjellshme të tregosh se ke shpirt.
- Nëse bashkëshortët nuk do të jetonin së bashku, martesat e mira do të ishin më të shumta.

[www.sigal.com.al](http://www.sigal.com.al)



Android Apps on Google Play  
SIGAL UNIQA



**SIGAL**



UNIQA GROUP AUSTRIA

## Çfarë përfiton nga paga një individ nëse investon për Pension Privat?

Çdo individ i punësuar, i cili dëshiron të ketë një Pension Privat, përfiton përjashtimin nga taksa deri në vlerën 250 000 lekë nga paga e tij vjetore ose 20.800 lekë në muaj.

### PËRFITIMI NGA PENSIONI PRIVAT PËR PUNONJËSIT

Për punonjësit me pagë bruto nga 30.000 deri në 130.000 lekë në muaj përfiton menjëherë 13% nga paga		Për punonjësit me pagë bruto mbi 130.000 lekë në muaj përfiton menjëherë 23% nga paga	
Investoni <b>5.000 Lekë/muaj</b> për Pension Privat	Investoni <b>20.800 Lekë/muaj</b> Për Pension Privat	Investoni <b>10.000 Lekë/muaj</b> për Pension Privat	Investoni <b>20.800 Lekë/muaj</b> për Pension Privat
Kurseni 650 lekë në muaj (5.000 Lekë * 13 %) ose	Kurseni 2.704 lekë/muaj (20.800 lekë * 13 %) ose	Kurseni 2.300 lekë në muaj (10.000 Lekë * 23 %) ose	Kurseni 4.784 lekë/muaj (20.800 lekë * 23 %) ose
<b>7.800</b> Lekë në vit	<b>32.448</b> Lekë në vit	<b>27.600</b> Lekë në vit	<b>57,408</b> Lekë në vit

**20.800**  
Lekë/muaj  
Shuma maksimale  
që përjasohet nga  
Tatimi

### Po një kompani çfarë përfiton nëse investon tek punonjësit e tij për Pension Privat?

Përveç përfitimit që ka vetë punonjësi edhe Biznesi **përfiton 1%** nëse investon për punonjësit e tij për Pension Privat.

\* Investimi në Pension e Privat është një mundësi e mirë për një pension të sigurtë dhe të ardhura të mjaftueshme për një jetë më të mirë gjatë kohës së pensionit.

Adresa: Qendra e Biznesit SIGAL, Blv. "Zogu I", Nr. 1, Tiranë, Shqipëri - Tel: (+355) 4 2233 308 - e-mail: info@sigal.com.al